

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 5981  
E martë, 21 janar 2020  
çmimi 0.40 €

## "Lufthansa" synon ta hapë korridorin ajror Prishtinë - Beograd



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### OPINION

## TË POSHTËRUARIT MBESIN TË POSHTËRUAR, ASNJËHERË TË RESPEKTUAR!

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## FUSHA E REALËT MAGNETIKE E MAGNETIT

Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan



### AKTUALE

## APOSTOLOVA: BE-ja MBETET E PËRKUSHTUAR PËR TA NDIHMUAR RRUJËN EVROPIANE TË KOSOVËS



### EKONOMI




## HARADINAJ THOTË SE KOSOVA DUHET TË KRIJOJË ZONË TË VEÇANTË EKONOMIKE ZVICERANE

## THAÇI MERR PJESË NË FORUMIN BOTËROR EKONOMIK TË DAVOSIT

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, HASHM THAÇI, KA MANDATUAR PËR KRYEMINISTËR KRYETARIN E LËVIZJES VETËVENDOSJE, ALBIN KURTI

# FILLOJNË 15 DITËT E KURTIT



Pas pranimit të propozimit të Lëvizjes Vetëvendosje, presidenti Hashim Thaçi ka mandatuar të hënën liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, për kryeministër të Kosovës. Dekreti presidencial tregon se jo më vonë se 15 ditë

kandidati për kryeministër duhet ta paraqesë përbërjen e qeverisë para Kuvendit dhe ta kërkojë miratimin e tij. Lideri i LV-së, Albin Kurti, përmes një videomesazhi ka ftuar Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) që t'i

kthehet tavolinës së bisedimeve për ta gjetur një gjuhë të përbashkët për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje. Ndërkaq zyrtarët e LDK-së kanë deklaruar se kjo parti ka vullnet për marrëveshje me LV-në

## A MUND TË FORMOHEN KOMISIONET PARLAMENTARE PA QEVERINË E RE?



Të hënën është mbajtur mbledhja e parë e kryesisë së Kuvendit të Kosovës e legjislaturës së VII, në të cilën janë bërë të njohura grupet parlamentare. Por vendi ende nuk ka qeveri të re të dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit. Pa formimin e qeverisë së re a mund të fillojë procesi i formimit të komisioneve parlamentare. Për këtë gjë flasin njohësit e proceseve politike Blerim Vela dhe Artan Murati

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.A.  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Basha: Do të bëjmë çdo gjë për integrimin

Tiranë, 20 janar - Lideri i opozitës Lulzim Basha, garanoi kryeministrin e Kroacisë, Andrej Plenković se ai dhe opozita në Shqipëri do të bëjnë gjithçka për të ndihmuar procesin e integrimit evropian. Basha publikoi një letër të 14 janarit, ku ai përshëndet kryeministrin kroat për marrjen e drejtimit të Presidencës së Bashkimit Evropian, një ngjarje që kreu i opozitës e cilëson si historike për shkak se kjo është hera e parë që Kroacia drejton presidencën e BE-së që kur u bë anëtar i Unionit në vitin 2013.

"Presidenca kroate e BE-së, është një arritje të cilën ne, në Shqipëri,

e vlerësojmë shumë, ashtu si edhe rajoni. Kam bindjen e plotë se nën drejtimin tuaj të Presidencës, proceset integruese për Shqipërinë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, do të avancojnë edhe më tej", thekson Basha në letërën e tij.

"Ju jam shumë mirënjohës për mbështetjen që më keni shprehur për Shqipërinë gjatë takimit që patëm nëntorin e shkuar, vë në dukje kreu i opozitës, duke e garantuar kryeministrin e Kroacisë për rolin e PD-së dhe opozitës në integrimin e vendit.

"Prioritetet tuaja në krye të BE-së janë shpresëdhënëse dhe shtysë për mua që të bëj çdo gjë që

mundem në emër të Partisë Demokratike dhe opozitës shqiptare, që të avancojmë procesin e integrimit në BE, pa vonesa të mëtejshme, siç përcaktohet edhe në kushtet e Bundestagut. Edhe pse marrja e Presidencës kroate po ndodh në momente sfiduese, jam i bindur se ju do t'i përmbushni prioritetet duke qenë edhe njëherë një shembull i shkëlqyer për ne", mbyll letërën e tij kreu i opozitës Lulzim Basha, duke i uruar Kroacisë një presidencë të suksesshme dhe duke mirëpritur drejtimin dhe mbështetjen e mëtejshme të kryeministrit kroat.



## Rama: Synimi ynë, të sigurojmë një armëpushim të plotë në Ukrainë

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në pozitën e kreu të OSBE-s tha se konflikti në Ukrainë vazhdon të prodhojë viktima civile që është diçka që duhet të ndalet dhe synimi ynë është të sigurojmë një armëpushim të plotë dhe të qëndrueshëm

**TIRANË, 20 JANAR** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në pozitën e kreu të OSBE-s, është duke zhvilluar një vizitë zyrtare në Ukrainë, gjë të cilën e kishte paralajmëruar ditë më parë.

Gjatë fjalës së tij në një konferencë me gazetarë, për krahas ministrit të Jashtëm ukrainas, Rama u shpreh se nuk është rastësi që Ukraina është vizita e tij e parë në këtë detyrë të re.

"Ju shpreh mirënjohjen për mikpritjen e ngrohtë, si dhe ju falënderoj për diskutimet produktive. Pres me padurim të takohem me kryeministrin dhe presidentin më vonë. Nuk është rastësi që Ukraina është vizita ime e parë në këtë detyrë të re, ajo reflekton rëndësinë e madhe që i kushtoj zgjidhjes së krizës. Në këndvështrimin tim kjo mbetet sfida më e ngutshme për

sigurinë dhe stabilitetin. Do të inkurajojmë respektimin e plotë të marrëveshjeve të Minskut. Por ndërkohë marrëveshjet po diskutohen dhe duke qenë se po diskutohen prej kohësh do kërkohej ende një gjë e tillë. Por është thelbësore jeta e njerëzve që jetojnë në zonat e prekura nga konflikti dhe aty ne do të punojmë fort. Garantimi i ndalimit të të shtënave dhe një armëpushim është jetik për njerëzit atje. Ky konflikt vazhdon të prodhojë viktima civile që është diçka që duhet të ndalet. Synimi ynë është të sigurojmë një armëpushim të plotë dhe të qëndrueshëm. Rifillimi i një dialogu të nivelit të lartë janë hapa të duhur, megjithëse rruga drejt paqes do vazhdojë", tha Rama. Ai shtoi se ndamë dhe me ministrin se kontributi që është



dhënë nga burrat dhe gratë e misionit të OSBE në Ukrainë është thelbësor për paqen, prandaj duhet forcuar me një buxhet solid, që ky mision të bëjë dhe më mirë rolin e vet.

"Shpresoj fort që moti të na lejojë të vazhdojmë drejt Ukrainës Lindore nesër ku dua ta shoh

zonën nga afër dhe ndikimin e këtij misioni. Ky është thelbi i misionit tonë sepse jemi të vetëdijshëm që shumë aktorë të mëdhenj po bëjnë përpjekje për këtë konflikt, por jo shumë nga këto përqendrohen te njerëzit realë, tek ata që përballen me këto mundime. Dëgjova nga

vetë ministri se sa vëmendje dhe përpjekje kanë bërë autoritetet ukrainase për të lehtësuar ata. Ne nuk po premtojmë mrekullinë, por jemi këtu sepse ne mund të bëjmë diçka më mirë sesa të tjerët për ata që janë në këtë situatë dhe që janë të pafajshëm", tha Rama.

## Ruçi: Objektivi kryesor i Parlamentit, hapja e negociatave

Tiranë, 20 janar - Të hënën ka nisur sesioni i ri i Parlamentit shqiptar për vitin 2020. Kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi u shpreh në fjalën e tij se objektivi kryesor i Kuvendit për këtë vit është hapja e negociatave.


"Objektivi do të jetë çelja e negociatave të anëtarësimit, rritja e rolit të Kuvendit në rolin e integrimit, me qëllim që të ketë mekanizëm më të mirë për

të mbikëqyrur punën e qeverisë. Do të punohet për zbatimin e planit të veprimit të KE-së dhe do të miratohet plani strategjik 2020-2025. Do të rishikojmë ligjin për rolin e Kuvendit në kuadër të procesit të integrimit bazuar në praktikën më të mira evropiane", tha Ruçi.

Gramoz Ruçi theksoi gjithashtu se reforma zgjedhore do të

bëhet realitet brenda datës 15 mars 2020.

"Do të miratojmë ligje të reja, për të harmonizuar legjislacionin për problemet natyrore sipas kodeve evropiane. Legjislacioni do të parashikojë ligje më të ashpra për ndërtimet. Do të kemi miratim të ligjeve më të mira sipas Parlamentit gjerman e atij zviceran", tha Ruçi.



# A mund të formohen komisionet parlamentare pa qeverinë e re?

Të hënën është mbajtur mbledhja e parë e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës e legjislaturës së VII, në të cilën janë bërë të njohura grupet parlamentare. Por vendi ende nuk ka qeveri të re të dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit. Pa formimin e qeverisë së re a mund të fillojë procesi i formimit të komisioneve parlamentare. Për këtë gjë flasin njohësit e proceseve politike Blerim Vela dhe Artan Murati

cionin për përfaqësim në Asambenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Po ashtu, në kryesi u bënë të njohura njoftimet e deritashme për krijimin e grupeve parlamentare, si në vijim: Grupi Parlamentar i LDK-së, i cili do t'i ketë 28 deputetë (kryetar Avdullah Hoti), Grupi Parlamentar i PDK-së, 24 deputetë (kryetar Bedri Hamza), Grupi Parlamentar Lista Serbe, 10 deputetë (kryetar Igor Simiq) dhe Grupi Parlamentar Multietnik, i cili do të kryesohet nga deputeti Albert Kinolli dhe do t'i ketë gjashtë deputetë. Ndërkaq LV-ja, AAK-ja dhe Nisma Socialdemokrate ende nuk kanë propozuar emrat e tyre për kryetar të grupeve parlamentare. Njohësi i proceseve politike në vend, Blerim Vela, ka thënë se tashmë, pas konstituimit të

Kuvendit dhe zgjedhjes së kryetarit, formimi i komisioneve parlamentare është rezultat i procesit politik të negociatave mes grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës. Ai ka thënë se ekziston praktika e mirëdetajuar parlamentare që bazohet në formulën e përfaqësimit proporcional, e cila përcakton numrin e kryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve parlamentare për secilin grup parlamentar në varësi të madhësisë së tij. Vela ka thënë se formimi i komisioneve parlamentare ligjërisht nuk është i lidhur me ndonjë proces jashtë Kuvendit. "Po ashtu, numri, emërtimi dhe anëtarësia e komisioneve parlamentare përcaktohet nga seanca plenare në bazë të propozimit të Kryesisë së Kuvendit pas marrëveshjes mes grupeve parlamentare. Ky proces

nuk është i lidhur me emërtimet e ministrive, pasi që në esencë Rregullorja e Punës së Kuvendit përmban listën e komisioneve parlamentare ashtu siç janë përcaktuar në vitin 2010. Ndërsa, me vendim të seancës së Kuvendit të përbërjes së re mund të ndryshohet numri, emërtimi dhe fushëveprimi i tyre", ka thënë ai. Vela ka pohuar se është përgjegjësi e kryesisë së re të Kuvendit ta fillojë procesin e krijimit të komisioneve parlamentare dhe funksionalizimin e tyre. "Ky proces ligjërisht nuk është i lidhur me formimin e qeverisë së re apo emërtimin e ministrive të reja. Politikisht, grupet parlamentare mund ta bëjnë një gjykim të tillë që kushtëzon krijimin e komisioneve parlamentare me qeverinë e re, por përsëri është përgjegjësi e seancës plenare të marrë vendim të tillë. Megjithatë, për momentin asgjë nuk e ndalon Kuvendin që ta bëjë formimin e tyre. Së këndejmi dhe duke u bazuar në Kushtetutën e Kosovës, përbërja e re e Kuvendit mund të fillojë të miratojë ligje, duke përfshirë edhe atë për projektbuxhetin e vitit 2020", ka thënë analisti Vela. Ndërkaq analisti tjetër, Artan Murati, ka thënë se nuk mund të ketë komisione parlamentare pa qenë e ditur sesa ministri do të jenë. "Komisionet krijohen në bazë të numrit të ministrive të cilat duhet të mbikëqyren. Ka edhe arsye të tjera të cilat nuk po i listoj. Legjislatura e shtatë, qeveria në ikje e legjislaturës së gjashtë, nuk funksionojnë bashkë. Kjo është shumë e qartë. Mos të krijohet konfuzion nëpër TV dhe mos të flitet për gjëra që nuk jemi të sigurt se qëndrojnë ashtu siç themi", ka thënë Murati.

**EPOKA ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 20 JANAR** - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e drejtuar nga Glauk Konjufca, kryetar, ka mbajtur të hënën mbledhjen e parë për legjislaturën VII. Në këtë mbledhje u shqyrtuan kërkesat për cak-

timin e delegacioneve të Kuvendit në dy institucione të rëndësishme ndërkombëtare. Kështu, kryesia shqyrtoi kërkesën dhe caktoi delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asambenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore-SEECIP si dhe delega-



## Lumezi takohet me menaxheren e projektit të iniciativës rajonale kundër korrupsionit

**PRISHTINË, 20 JANAR (ER)** - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka pritur të hënën në takim njoftues menaxheren e Projektit të Iniciativës Rajonale Kundër Korrupsionit, Desislava Gotskova. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për forcimin e kapaciteteve të prokurorëve për zbatimin efektiv të kthimit të pasurisë në pajtueshmëri me praktikën evropiane përmes konfiskimit të zgjeruar, nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe promovimin e praktikave të suksesshme në rajon në kuadër

të projektit "Fuqizimi i antikorrupsionit në Evropën Juglindore përmes përmirësimit të masave për sekuestrimin e pasurisë". Kryeprokurori Lumezi dhe menaxherja Gotskova kanë vlerësuar faktin se bashkëpunimi rajonal, përdorimi i instrumenteve ndërkombëtare në ofrimin e kornizës për hartimin e së drejtës vendore dhe zbatimi efektiv i legjislacionit ekzistues janë me rëndësi thelbësore për suksesin e masave antikorrupsion, luftimin e të gjitha formave të krimit dhe ngritjen e besimit në institucionet e drejtësisë.



Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka mandatuar për kryeministër kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti

# FILLOJNË 15 DITËT

Pas pranimit të propozimit të Lëvizjes Vetëvendosje, presidenti Hashim Thaçi ka mandatuar të hënën liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, për kryeministër të Kosovës. Dekreti presidencial tregon se jo më vonë se 15 ditë kandidati për kryeministër duhet ta paraqesë përbërjen e qeverisë para Kuvendit dhe ta kërkojë miratimin e tij. Lideri i LV-së, Albin Kurti, përmes një videomesazhi ka ftuar Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) që t'i kthehet tavolinës së bisedimeve për ta gjetur një gjuhë të përbashkët për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje. Ndërkaq zyrtarët e LDK-së kanë deklaruar se kjo parti ka vullnet për marrëveshje me LV-në



## **EPOKA ERE** Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 29 JANAR** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mandatuar të hënën liderin e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, kandidat për kryeministër të Kosovës. Dekretin e tij presidenti Thaçi e ka nënshkruar pasi LV-ja përmes një letre zyrtare ka bërë propozimin për Kurtin. Dekreti presidencial, që mban emrin e mandatarit për formimin e qeverisë së re, tregon se Kurti brenda 15 ditëve duhet t'ia paraqesë Kuvendit përbërjen e Qeverisë. "1. Z. Albin Kurti i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për kryeministër për ta formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës; 2. Kandidati nga pika 1 e këtij dekreti jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas emërimit parqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e

Kuvendit; 3. Dekreti hyn në fuqi në datën e nënshkrimit", thuhet në dekretin presidencial, i cili më pas u është dërguar kandidatit për kryeministër, Albin Kurti dhe Kuvendit të Kosovës. Më pas lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, përmes një videomesazhi ka bërë me dije se ende nuk ka një marrëveshje për koalicionin qeverisës me Lidhjen Demokratike të Kosovës. "Propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje si subjekt fitues në zgjedhjet e 6 tetorit kemi dashur ta dërgojmë te presidenti pas një marrëveshje me LDK-në. Në mbledhjen konstituive më 26 dhjetor shkova pa pasur një marrëveshje. Edhe te presidenti më 6 janar shkova pa marrëveshje paraprake. Dy javë pas takimit katërrminutësh nuk kemi marrëveshje. Ne nuk e kemi pranuar propozimin e LDK-së, por jemi të gatshëm për takime të tjera", ka thënë Kurti.

Ai ka ripërsëritur se nuk mund të kthehet në të kaluarën, në vitin 2019. "Ata s'e kanë pran-

uar propozimin tonë të fundit, ndonëse, ndryshe nga dakordimi, nuk e trajtuan fare në Këshillin e Përgjithshëm. Qëndrimi se takohemi vetëm për ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes, pra qasja 'merre ose lëre', do të thotë lëre. Unë besoj se ne mund të kthehemi dhe e kemi detyrim ndaj të gjithë jush që të kthehemi në tavolinën e bisedimeve, për të mos dalë nga ajo deri në gjetjen e një gjuhe të përbashkët dhe arritjen e marrëveshjes sonë", ka deklaruar ai.

Kurti ka ftuar LDK-në që t'i kthehet tavolinës së bisedimeve. "Ne si Lëvizje Vetëvendosje kemi marrë mandatin ta bëjmë qeverinë që ju e

dëshironi, e që vendit i duhet me aq urgjencë. As më shumë e as më pak. E kemi filluar duke e çliruar nga kapja, udhëheqjen e Kuvendit: nuk është më aty ai 'Pronto' kryeparlamentari që shante e kërcënonte nga foltorja, por kryetari i ri, Glauk Konjufca. Unë besoj se ne mund të kthehemi e duhet të kthehemi në tavolinën e bisedimeve. Në ditët në vijim do t'i takoj edhe përfaqësuesit e pakicave", ka thënë Kurti.

Nënkryetarja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se kjo parti ka vullnet për marrëveshje me Lëvizjen Vetëvendosje. Ajo ka deklaruar se të dy partitë duhet t'i shfrytëzojnë maksimalisht

për të biseduar dy javët në vazhdim. "Qëndrimi i LDK-së është thënë qartë gjatë ditëve që shkuan. Është konfirmuar dhe nga ne që jemi pjesë e organeve të LDK-së dhe nga vetë kryetari që LDK-ja ka vullnet që të arrihet një marrëveshje me Vetëvendosjen. Tanimë që zyrtarisht e kemi mandatimin e kandidatit për kryeministër dhe koha është e përcaktuar me Kushtetut të vendit, ajo për të cilën bëj thirrje unë, është që dy javët e ardhshme të shfrytëzohen maksimalisht për arritjen e marrëveshjes, e jo për fajësime ndaj njëra-tjetrës", ka thënë ajo. Osmani ka vlerësuar se veprimet e Kurtit me postimin e videomesazheve nuk janë qasje

## Apostolova: BE-ja mbetet e përkushtuar për ta ndihmuar rrugën evropiane të Kosovës



Prishtinë, 20 janar (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka takuar të hënën shefen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, përfaqësuesen e posaçme të BE-së, Nataliya Apostolova, me të cilën ka diskutuar për zhvillimet aktuale politike në vend, për procesin e ndërtimit të institucioneve të reja, për agjendën evropiane të Kosovës dhe obligimet e Kosovës në këtë proces. Shefja e misionit të BE-së uroi kryeparlamentarin Konjufca për

përgjegjësinë e re institucionale. Ajo ka theksuar se Bashkimi Evropian mbetet i përkushtuar për ta ndihmuar rrugën evropiane të Kosovës në të gjitha proceset dhe hapat e saj.

Kryeparlamentari Konjufca ka theksuar përkushtimin e Kuvendit për të vazhduar dhe forcuar më tej bashkëpunimin me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe se Kosova do t'i vazhdojë angazhimet e saj për përmbushjen e të gjitha kriterëve që ajo ka para vetes në procesin eurointegruar.

# E KURTIT




e mirë për arritje të marrëveshjes për bashkëqeverisje. "Unë nuk besoj që kjo qasje i ndihmon arritjes së marrëveshjes. Palët duhet të ulen me synimin për të gjetur një mes, një kompromis në atë se të dyja palët e kuptojnë se janë duke ndërtuar të ardhmen e Kosovës", është shprehur Osmani. LDK-ja ka bërë me dije se sot (e martë) do ta mbajë mbledhjen e kryesisë. Ky vendim vjen pas zhvillimeve të fundit politike në vend, pas mandatimit të Albin Kurtit për kryeministër të Kosovës nga presidenti Hashim Thaçi. Mbledhja e Kryesisë së LDK-së pritet të mbahet në orën 14:00 në selinë qendrore të kësaj partie në Prishtinë.

## PDK-ja: LV-ja është shkak-tarja e vetme e krizës

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka bërë me dije se është duke i përcjell me shqetësim zhvillimet në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe LDK-së, të cilat, sipas kësaj partie, janë duke e vazhduar fushatën parazgjedhore. Partia e Kadri Veselit përmes një komunikate për medie ka theksuar se parimet e LV-së dhe LDK-së të prezantuara zëshëm janë shndërruar në pazare për karrige. "Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është e bindur se përgjegjësia për t'i formuar institucionet e reja i takon fituesit të

zgjedhjeve dhe nuk bën të dëmtohet ky koncept i shëndoshë në demokracinë e re të Kosovës. PDK-ja ka treguar konstruktivitetin e saj duke pranuar rezultatit zgjedhor dhe kaluar në opozitë menjëherë pas përfundimit të procesit të votimit. Nuk ka bërë asnjë ankesë në Gjykatë Supreme për ta zvarritur certifikimin e procesit zgjedhor. Për më tepër, e ka lënë veten në mënyrë të qartë jashtë ekuacioneve e tavolinave të bisedimeve për qeverisje, duke u deklaruar pa asnjë ekuivok dhe ripotencuar se do të qëndrojë në opozitë", është thënë në komunikatën e PDK-së, duke shtuar se LV-ja është shkakhtarja kryesore e vonesës së formimit të qeverisë së re. "Prandaj, çdo përpjekje për të gjetur justifikime, ose për t'i tjetërsuar përgjegjësitë në këtë vonesë nga Lëvizja Vetëvendosje, është e papranueshme. Kjo parti politike është shkakhtarja kryesore e vonesës aktuale dhe dhënia fund e kësaj krize është tërësisht në dorën e saj. Qeveria ka dhënë dorëheqje që më 29 korrik të vitit të kaluar. Faji dhe fati për qeverisjen e re është vetëm në dorën e Vetëvendosjes që prej



106 ditëve", ka vlerësuar PDK-ja. Kjo parti ka paralajmëruar se do t'i mbajë llogaridhënese partitë që po e zvarrisin formimin e këtij procesi. "Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje duhet t'i marrin përgjegjësitë qeverisëse, por qytetarët e Kosovës do t'i kuptojnë shpejt mashtrimet dhe

iluzionet që ata kanë kultivuar si dhe ta shohin dështimin e ideve që kanë promovuar. PDK-ja si parti opozitare do t'i mbajë llogaridhënese dhe nuk do të lejojë të zhbëhen arritjet e deritanishme të Republikës së Kosovës", është në komunikatën e PDK-së.

## Ambasada Britanike mirëpret mandatimin e Kurtit për kryeministër

Ambasada e Britanisë së Madhe në Prishtinë e ka mirëpritur vendimin e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, për mandatimin e liderit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, si kandidat për kryeministër për formimin e qeverisë së re. Kjo ambasadë nëpërmjet faqes zyrtare në "Facebook" ka theksuar se politikanët duhet të tregojnë

gatishmëri për formimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit të vitit 2019. "Ne e mirëpresim vendimin e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, për ta emëruar Albin Kurtin kandidat për kryeministër, për formimin e qeverisë së re. Votuesit kosovarë kanë pritur tre muaj e gjysmë për këtë çast. Shpresa e tyre dhe dëshira për të

ndryshuar, e shprehur aq qartë më 6 tetor, duhet të respektohet. Politikanët e zgjedhur të Kosovës dhe partitë e tyre tani duhet të tregojnë kurajë dhe kreativitet për formimin e qeverisë që reflekton dëshirën e elektoratit. Ne bëjmë thirrje për përparim të shpejtë në negociatë, në një frymë tolerance dhe partneriteti", ka shkruar Ambasada Britanike.

## UPZ-ja arrin marrëveshje bashkëpunimi me Kutahya Dumlupinar University nga Turqia

PRIZREN, 20 JANAR (ER) - Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren të hënën ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me Kutahya Dumlupinar University nga Turqia. Marrëveshja është nënshkruar nga Prorektori për Marrëdhënie me Jashtë dhe Ngritje të Cilësisë, prof. ass. dr. Soner Yildirim dhe prof. dr. Muammer Gavas zëvendësrektor. Në takim ishin edhe Prorektori për Mësimdhënie, Kërkime Shkencore dhe Çësht-

je të Studentëve, prof. ass. dr. Shemsi Morina dhe prof. dr. Abdurrahman Unsal, drejtor i Zyrës për Studentët Ndërkombëtarë. Marrëveshja është arritur për projekte të përbashkëta ndërkombëtare, programet e mobilitetit Erasmus+ dhe Mevlana, projekte kërkimore dhe organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, seminare dhe takime akademike të interesit të përbashkët.



ShBA ndërmjetëson marrëveshjen për hapjen e linjës ajrore Prishtinë - Beograd

# 'Lufthansa' synon ta hapë korridorin ajror Prishtinë - Beograd

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ka nënshkruar të hënën në Berlin një marrëveshje me aviokompaninë gjermane "Lufthansa", për ta hapur linjën ajrore Prishtinë - Beograd. Me këtë rast, drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, Eset Berisha, ka thënë se ky është një hap përpara drejt hapjes së korridoreve të reja përmes hapësirës ajrore në drejtim të shteteve fqinje

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 JANAR - Të hënën në Ambasadën Amerikane në Berlin, me anë të një ceremonie, në praninë e ambasadorit amerikan Richard Grenell, përfaqësuesit e kompanisë "Lufthansa" i kanë dorëzuar Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës letrën me të cilën i njoftojnë autoritetet e Kosovës për operimin e aviokompanisë "Lufthansa" në linjën Prishtinë - Beograd. Lidhur me këtë institucionet e Kosovës do ta ofrojnë përkrahjen e nevojshme si për fluturimet e tjera.

Të gjitha fluturimet kërkojnë aprovimet dhe licencat sipas kërkesave rregullatore të zbatueshme në Republikën e Kosovës si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjen për Hapësirën e Përbashkët Ajrore Evropiane (HPAE (ECAA))

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, Eset Berisha, është shprehur se kjo letër është një hap tjetër përpara për angazhimin e institucioneve të Kosovës për normalizim të plotë të hapësirës ajrore në Kosovë. "Me këtë vihet kontakti në mes dy autoriteteve të aviacionit civil, në mes të Kosovës dhe Serbisë, si partnerë të barabartë. Por, ky është hap i parë drejt normalizimit të plotë të hapësirës ajrore të Kosovës dhe hapjen e korridoreve ajrore me të gjitha shtetet përreth. Nga kjo do të përfitojnë më së shumti qytetarët e Kosovës që shfrytëzojnë shërbimet e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës", ka thënë ai.

Berisha u shpreh mirënjohës për ambasadorin Grenell, për administratën amerikane, për NATO-n dhe për KFOR-in për mbështetjen e tyre në përpjekjet e Kosovës për normalizim të plotë të hapësirës ajrore dhe të trafikut ajror në Kosovë.

Pranishëm në konferencën për media në Berlin, ku u njoftua

publiku për këtë çështje, ishte edhe këshilltari për siguri kombëtare i presidentit Trump, Robert O'Brien. Fillimi i linjës ajrore Prishtinë - Beograd mund të bëhet pas aranzhimeve mes autoriteteve të aviacionit dhe NATO-s në kuadër të mekanizmit për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit Perëndimor.

Për marrëveshjen në fjalë ka njoftuar edhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit të Kosovës. "Ky hap është mirëpritur nga institucionet e Republikës së Kosovës, të angazhuar për normalizim të hapësirës ajrore, meqë shënon njohje të autoriteteve të aviacionit civil mes dy shteteve dhe bashkëpunim mes tyre, pas 20 vjetëve. Përmes kësaj linje mundësohet lëvizja e lirë e qytetarëve dhe mallrave edhe përmes transportit ajror", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

Edhe presidenti Hashim Thaçi ka mirëpritur nënshkrimin e letrës së qëllimit ndërmjet kompanisë ajrore prestigjioze gjermane "Lufthansa" dhe Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, e cila mundëson hapjen e linjës ajrore Prishtinë - Beograd. "Sigurisht se kjo ngjarje shënon një hap tjetër në përpjekjet tona për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Prandaj, në emër të institucioneve shtetërore dhe qytetarëve tanë shpreh mirënjohjen e thellë për ambasadorin e ShBA-së në Berlin, Richard Grenell, si dhe këshilltarin për siguri kombëtare të presidentit Trump, Robert O'Brien, për kontributin e tyre për këtë marrëveshje, e cila pritet ta lehtësojë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave në të ardhmen", ka thënë presidenti Thaçi.

Edhe kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka quajtur hap gjigant nënshkrimin e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë për rifillimin e linjës ajrore Prishtinë - Beograd. Ai ka



thënë se një marrëveshje e tillë është një hap i rëndësishëm drejt avancimit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë. "Nisma për ta hapur rrugën e tretë ajrore civile të Kosovës për fluturime komerciale në Serbi, pas Shqipërisë dhe Maqedonisë, është një hap gjigant për avancimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe konsolidimin e sovranitetit të Kosovës", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në

"Twitter". Në lidhje me këtë edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka reaguar. "Bazuar në letrat e synimeve të nënshkuara sot në Berlin, e mirëpres qëllimin e 'Eurowings' dhe 'Grupit Lufthansa' për të vendosur fluturime të drejtpërdrejta midis Beogradit dhe Prishtinës. Ky është një hap i rëndësishëm i cili do ta bëjë qarkullimin e njerëzve dhe mallrave më të lehtë

dhe të shpejtë brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor. Sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, komandanti i misionit tonë të KFOR-it e ka autoritetin e hapësirës ajrore mbi Kosovë dhe NATO do të mbetet i përfshirë përmes procesit afatgjatë të Takimit të Normalizimit të Aviacionit në Ballkan të cilin e udhëheqim ne", ka thënë Stoltenberg.

## KDI-ja kërkon transparencë për marrëveshjen e fluturimeve direkte Prishtinë - Beograd

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) përmes një reagimi ka kërkuar më shumë transparencë nga autoritetet e Republikës së Kosovës në lidhje me marrëveshjen që është bërë për vendosjen e linjës së fluturimeve direkte Prishtinë - Beograd. "Sot është bërë e ditur arritja e një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë, në Ambasadën e ShBA-së në Berlin, për vendosjen e linjës së fluturimeve direkte Prishtinë - Beograd nëpërmjet kompanisë ajrore gjermane 'Lufthansa'. Deri tani autoritetet kosovare kanë dhënë informa-

cione të kufizuara lidhur me përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje. Qytetarët e Kosovës janë të painformuar mbi përmbajtjen e saj dhe procesin vendimmarrës që i ka paraprirë arritjes së kësaj marrëveshjeje. Për më tepër, publiku nuk ka informacion për implikimet që kjo marrëveshjeje mund të sjellë, p. sh., me çfarë dokumente udhëtimi do të mundësohet udhëtimi i qytetarëve në mes të këtyre dy kryeqyteteve dhe çështje të tjera që derivojnë nga kjo marrëveshje", është thënë në reagimin e KDI-së. KDI-ja kërkon nga autoritetet e

Republikës së Kosovës që ta njoftojnë publikun mbi përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje dhe implikimet e saj. "Duke vlerësuar angazhimin e vazhdueshëm dhe përfshirjen direkte të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në procesin e dialogut dhe normalizimit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, KDI-ja u bënë thirrje autoriteteve të Republikës së Kosovës që të përkushtohen për transparencë dhe llogaridhënie, si parakusht për rritjen e besimit të publikut në procesin e normalizimit", është thënë në këtë reagim të KDI-së.

# Ministri Tahiri: Jonuz Musliu, veprimtari i kauzës sonë kombëtare që sfidoi regjimin e Millosheviqit

"Që në referendumin e marsit të vitit 1992, për të vazhduar paseshtur deri te radhët e Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, ku kulmoi si një ndër përfaqësuesit më të spikatur të saj. Ai pa dyshim se ishte një prej njerëzve të dalluar të kauzës sonë kombëtare që e sfidoi regjimin e Millosheviqit deri në shembje", kështu ka thënë ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, në akademinë përkujtimore në dyvjetorin e vdekjes së veprimtarit të çështjes kombëtare, Jonuz Musliu



referendumin e marsit të vitit 1992, për të vazhduar paseshtur

**EPOKA  
ERE**

**Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 20 JANAR** - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka marrë pjesë në akademinë përkujtimore, në dyvjetorin e vdekjes së veprimtarit të çështjes kombëtare, Jonuz Musliu. Me këtë rast, ministri Tahiri ka thënë se veprimtari Musliu ishte një idealist i pashuar, që ishte angazhuar me gjithë qenien, me të vetmin qëllim avancimin dhe përmirësimin e të drejtave politike, kulturore dhe kombëtare të shqiptarëve.

"Për shkak të këtij përkushtimi heroik, Jonuz Musliu nuk mund të kalonte pa u vënë në shënjestër të regjimit të Millosheviqit, në shënjestër të cenimit, burgimit e pengesave të njëpasnjëshme, përballë të cilave nuk u dorëzua asnjëherë", ka thënë Tahiri. Ministri Tahiri gjatë kësaj akademie ka pohuar se veprimtari Musliu ishte i angazhuar kundër regjimit diktatorial të Millosheviqit, në aktivitete politike kudo dhe në secilën rrethanë kur shfaqej një shpresë për liri e barazi. "Që në



deri te radhët e Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, ku kulmoi si një ndër përfaqësuesit më të spikatur të saj. Ai pa dyshim se ishte një prej njerëzve të dalluar të kauzës sonë kombëtare që e sfidoi regjimin e Millosheviqit deri në shembje", u shpreh Tahiri. Para të pranishmëve ministri Tahiri ka thënë se Kosova dhe Lugina kanë qenë i njëjti burim identitar dhe këtë unitet, sipas tij, e kanë ruajtur e kultivuar veprimtarët si Jonuz Musliu. "Kosova dhe Lugina historikisht kanë qenë e janë edhe sot e kësaj dite pjesë të të njëjtit burim identitar. Janë pjesë e të njëjtit ideal. Të së njëjtës sferë politike e kulturore. Dhe këtë unitet e kanë ruajtur e kultivuar pikërisht njerëzit si Jonuzi", ka thënë Tahiri. Sipas ministrit Tahiri, veprimtari Musliu me moralin, guximin, mendjen dhe vetëflijimin e pashoq u shndërrua në një nga pishtarët e çmuar që dig-

jeshin për t'ua rrëfyer bashkëkombëseve të tyre, rrugën e drejtë, të dinjitetit, mëkëmbjes dhe shpëtimit. "Jeta e Jonuz Musliut në tërë ciklin e saj, ngjashëm si edhe bashkëveprimtarëve të tij, ngjashëm e njëjtë dhe e pandashme me kronikën historike të përpjekjeve të kombit tonë për emancipim, liri e të drejta të barabarta për çdo pjesëtar të popullit shqiptar. Ai, ngjashëm si edhe shokët e tij të idealit, janë ikonat më të ndritura në galerinë tonë kombëtare dhe në historinë tonë më të re", është shprehur Tahiri.

Krejt në fund, ministri Tahiri ka thënë se Jonuz Musliu me veprimtarinë e tij aktive politike dhe përpjekjen konstante do të mbetet një shembull i përherëshëm në kujtesën tonë kolektive dhe inspirim për gjeneratat e reja. "Jeta e tij paraqet asgjë më pak sesa një model se çka do të thotë të jetosh në shërbim të kombit", ka deklaruar Tahiri.

## Dënimin mund ta paguani në veturën e policisë

**PRISHTINË, 20 JANAR (ER)** - Çdokush që bie ndesh me rregullat e komunikacionit, e që për këtë mund të gjobitet nga Policia e Kosovës, do të mund ta paguajë gjobën në vendin ku gjobitet. Kjo është bërë me dije pas takimit që drejtori i PK-së, Rashit Qalaj, pati të hënën me kryeshefin ekzekutiv të Postës së Kosovës, Shefqet Avdija.

Në këtë takim u nënshkrua edhe marrëveshja e bashkëpunimit për vendosjen e POS-ve në objektet dhe veturat policore, në mënyrë që qytetarët t'i paguajnë pagesat e gjobave për kundërvajtje edhe me kartela bankare. "Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, priti sot në takim kryeshefin ekzekutiv të

Postës së Kosovës Sh. A., Shefqet Avdija, me ç'rast nënshkruan edhe marrëveshje të bashkëpunimit për vendosjen e POS-ve në objektet dhe veturat policore, në mënyrë që qytetarët t'i paguajnë pagesat e gjobave për kundërvajtje edhe me kartela bankare", ka njoftuar Policia e Kosovës.



# TË POSHTËRUARIT MBESIN TË POSHTËRUAR, ASNJËHERË TË RESPEKTUAR!



**Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA**

**Gjykata që poshtëron të drejtën historike dhe gjendjen faktike:** Që nga dalja nga burgu në vitin 1990 e deri më sot jam bërë pjesë e KMDLNj-së sikur që kam qenë pjesë e çdo zhvillimi në Kosovë. Atëherë, në vitin 1990, e formuam NKMDLNj-në në Besianë pasi Baca Adem kishte një projekt që e tërë Kosova, por edhe hapësira ku jetojnë shqiptarët, e që pamëshirshëm terrorizoheshin nga ish-Jugosllavia dhe Serbia, për faktin se kërkon të jenë të lirë, të vendosnin vetë për fatin e tyre dhe të trajtoheshin sikur të gjithë qytetarët e tjerë e që nuk ishte ashtu sepse burgjet jugosllave dhe serbe ishin të stërmëshura me të burgosur politikë shqiptarë, të mbulohej me informata e që pastaj shpërndaheshin në të gjitha adresat e rëndësishme në botë. Me një fjalë, thuaja 90 për qind e të burgosurve politikë në burgjet jugosllave ishin shqiptarë. Nën këshillin për të drejtat e njeriut e themeluar në Besianë së bashku me Nexhmi Balën, Arif Ejupin, Selman Hoxhën, Sylejman Blakun, Fehmi Blakorin dhe shumë veprimtarë të tjerë që, në radhë të parë, ishin kombëtarë e pastaj merreshin edhe me të drejtat e njeriut. Pas vitit 1995 drejtimin e NKMDLNj-së në Besianë e mori Fadil Lepaja, kurse unë kalova në Prishtinë, në selinë e KMDLNj-së. Baca Adem më propozoi të bëhem sekretar e që fillimisht e refuzoja por se, në një takim me gjeneralin Shaban Shala, e që asokohe ishte nënkryetar i KMDLNj-së, më bindi ta pranoj propozimin duke thënë se së shpejti do të ketë luftë në Kosovë, prandaj duhet ta mbulojmë terrenin me aktivistë që do të sigurojnë informata për shkelje të drejtave të njeriut sikur edhe të përkrahim edhe luftën çlirimtare me të lavdishmen Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Stafi i atëherëshëm ishte shumë sakrifikes, motivues dhe punonte në kushte të presionit të vazhdueshëm. Sekretari i atëherëshëm i KMDLNj-së, Sami Kurteshi, ishte dhunuar fort fizikisht nga policia serbe në zyrat e selisë në Prishtinë prandaj, për këtë arsye, por edhe të tjera, ishte larguar në Zvicra ku u organizua politikisht, për t'u dënuar

pastaj me burg të rëndë. KMDLNj në atë kohë kishte në radhët e veta thuaja të gjithë avokatët më të zotët në Kosovë si: Bajram Kelmendi, Nekibe Kelmendi, Adem Bajri, Mustafë Radoniqi, Fazli Balaj, Destan Rukiqi, Lirije Osmani, Selatin Ahmeti, Mejdi Dehari dhe të tjerë, prandaj në mënyrë shumë profesionale përgatisnin kallëzime penale sikur që përfaqësonin palët para gjykatave. Për këtë e pësuan me ekzekutim, pa gjyq, të Bajram Kelmendit me dy djem, u rrah keq dhe vetëm fati e shpëtoi Destan Rukiqin që ishte mbrojtës i Nait Hasanit, të kidnapuar nga policia serbe pas rënies heroike të Zahir Pajazitit, Edmond Hoxhës dhe Hakif Zejnullahut. Edhe Lirie Osmani kishte presion shkaku se mbrojtja, pa kompensim material, të arrestuarën Zarie Podrimçaku që ishte aktiviste e KMDLNj-së, por edhe pjesë e bërthamave të para të UÇK-së. Kur Baca Adem, në vitin 1996, mori drejtimin e Partisë Parlamentare të Kosovës, nuk pranoi që edhe unë t'i bashkohem, por tha se është mirë të qëndrojmë në KMDLNj. Edhe kur e formoi Zyrën e UÇK-së në Prishtinë më tha të qëndrojmë në KMDLNj, ndonëse thuaja çdo ditë kam qenë në Zyrën e UÇK-së e cila ka qenë e mbikëqyrur 24 orë nga policia e Serbisë sikur edhe banesa ku jetonte Baca, afër shkollës "Elena Gjika" në Prishtinë.

**Anëtarë të KMDLNj-së ishin shumë luftëtarë të UÇK-së si:** Shaban Shala, Remzi Ademaj - komandant Petriti, Zahir Pajaziti, Besnik Rastelica, Refki Suma, Dr. Hafir Shala, Xhavit Haziri, Rexhep Bislimi, Bajrush Xhemajli, Elmi Reçica e shumë të tjerë që, edhe më tutje mbetën aktivistë për të drejtat e njeriut por se tani këto të drejta i mbronin me armë dhe me luftë pasi nuk i mbeti mundësi tjetër. Realisht, deri në kohën e fillimit të bombardimeve të NATO-s, çdo mëngjes para se të shkojë në zyrën e KMDLNj-së e që me bujarinë e Dr. Rexhep Bojës ishte vendosur në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, shkoja te Baca Adem ku afërsisht dy orë rrinim bashkë dhe koordinonim aktivitetet e përbashkëta. Kështu, në një mëngjes, duke shkuar te Baca kalova rrugës ku kishte shtëpinë Rexhep Dallduri (UKA) e cila ishte rrethuar me nja 30-40 policë. I tregova Bacës dhe ai menjëherë tha se mund ta kenë arrestuar Agron Ramadanin që ishte shoqëruar i Bacës e që doli të jetë e vërtetë.

**Si funksiononte KMDLNj në rrethana të luftës:** Stafi i KMDLNj-së ishte shumë përkushtues ndër- sa barrën kryesore sikur edhe

rrezikun e kishin anëtarët në terren si: Halit Berani, Sabit Kadriu, Tahir Demaj, Remzi Ademaj, Fazli Abdullahu, Murat Musliu, Adem Meta, Xhemë Binaku, Ukë Krasniqi dhe Agim Vrellaku, Ajnishahe Halimi, Bajrush Xhemajli, Kadri Kryeziu, Sokol Dobruna, Ekipi i lartpërmendur nga Besiana, Refki Suma, Haxhibeqirët nga Gjakova, Ruzhdi Jashari, Gashi nga Lipjani, Hysen Merovci, Zenel Bujupaj, Ismet Sopi, Shaip Kamberi, Binak Dinaj, Arbër Xhaferi dhe qindra dhe mijëra aktivistë, një numër i të cilëve edhe u flijuan në fushën e nderit, në shërbim të kombit, lirisë dhe bashkimit kombëtar! Stafi në Prishtinë përbëhej nga pjesa që përgatiste informata, raporte, i përkthente ato në gjuhën angleze, serbe dhe frënge e pastaj, Ibrahim Makolli si monopolist në njohuritë e punës me kompjuter i shpërndante në adresat relevante. Në gjuhën angleze përkthenin, Arjeta Emra, Violeta Hamidi, Fisnik Gruda, Zinaide Kuçi dhe Nedime e që udhëhiqeshin nga një njohës i shkëlqyer i anglishtes, Ismet Bërdynaj i cili, më shumë kishte njohuri për Shekspirin se për Kadarenë. Në gjuhën serbe përkthente Vehap Shita kurse në gjuhën frënge profesor Sylaj. Pjesë e stafit anglishtfolës ishte edhe Mimoza Ahmetaj që pastaj bëri karrierë të pabesueshme politike. Naime Sherifi dhe Basri Berisha së bashku me Xhavit Hazirin u bënë pjesë shumë kontribuuese e Shërbimit për Informim të Këshillit (kemi qenë SHIK shumë para SHIK-ut!!!) e që për udhëheqës e kishin Halime Morinën - Limkën. Kontribut të jashtëzakonshëm në atë kohë në KMDLNj kanë dhënë; Flaka Surroi, Shukrije Gashi, Nazlije Ballo, Flora Brovina dhe Sevdije Ahmeti. Pas largimit të Bacës Adem nga KMDLNj, një organizatë nga Beogradi, me përkrahjen e një insajderi nga KMDLNj deshën të bëjnë një puç e që deshtoi. Në aspektin gjuhësorë (në gjuhën shqipe) ishin të shkëlqyeshëm Prof. Dr. Ymer Jaka dhe Binak Ulaj kurse Baca Vehap i përmirësonte gjuhësisht raportet të cilat pastaj i rileoja dhe i lëshoja për shpërndarje për opinion. Akademik Pajazit Nushi ishte shumë bashkëpunues duke na i lënë duart e lira dhe, më duhet të shtojë se asnjëherë gjatë qëndrimit 25-vjeçar, herë si kryetar e herë si zv/kryetar i KMDLNj-së, nuk e ka kundërshtuar asnjë informatë, kumtesë, komunikatë apo raport të KMDLNj-së. Ekipi që ka shkuar nga zyra qendrore në terren e kanë përbërë: Nuhi Ahmeti, Avdullah Dërguti, Elmi Reçica,

Binak Ulaj, Halime Morina dhe, disa herë kam qenë edhe unë. Në shumë raste kemi bashkëpunuar me Qendrën Informative të Kosovës duke i furnizuar me informata apo duke e marrë përgjegjësinë për materialet (fotografitë) që dokumentonin dhunën për të cilët aktivistët e LDK-së deklarorin se i kemi marrë në KMDLNj kur e kishin pisk me Policinë e Serbisë. Pra edhe atëherë ka qenë një bashkëpunim i ngushtë midis QIK-ut (Qendrës Informative të Kosovës) dhe SHIK-ut (Shërbimi për Informim i KMDLNj-së). Ishte propozim i Bacës Adem të formohej një Agjenci Kombëtare për Informim dhe për këtë duhej të bashkoheshin QIK-u dhe SHIK-u. Jam takuar dhe jemi takuar disa herë me Xhemajl Mustafën dhe Enver Malokun që me vullnet kanë pranuar këtë ide por se "ka hasur sharra në gozhdë..." në nivelet e vendim-marrjes politike.

**Gjykata Speciale për të pafytyrët e specializuar:** Pas përfundimit të luftës, në Kosovë, sistemin gjyqësor, prokurorial dhe hetues, 100 për qind e kontrollonin UNMIK-u dhe pastaj EULEX-i ndërkaq që vendorët, ose ishin në shërbim të tyre, ose i binin kavallit, pa i pyetur askush për asgjë. Këto dy misione kryesisht bashkëpunonin me Serbinë dhe mbeturinat e saj të instaluar thuaja në të gjitha nivelet institucionale në Kosovë. Sidomos për fushat e krimeve të luftës, krimeve ndëretnike dhe rasteve të korrupsionit të profilit të lartë apo, siç i quanin ata, "peshqit e mëdhenj të korrupsionit". Realisht, nëse vendorët ishin peshq të mëdhenj të korrupsionit e që ka të tillë, ndërkombehtarët lirisht mund të llogariten si peshkaqenë apo balena të korrupsionit për faktin se kishin kontroll të plotë të fondeve ndërkombehtarë dhe financave vendore. Atëherë, si KMDLNj patëm kërkuar të formohet një Gjykatë për Krime Luftë në Kosovë sikur që ishin formuar në vendet e rajonit. Faktori ndërkombehtar në Kosovë nuk ka qenë fare i interesuar të hetojë apo gjykojë krimet që i kanë bërë serbët në Kosovë apo që këtë e kanë bërë sa për të thënë kurse, jetësisht kanë qenë të interesuar të hetojnë krimet ndaj serbëve në Kosovë dhe shqiptarëve lojalë ndaj Serbisë apo bashkëpunëtorëve besnikë të Serbisë. Nuk kanë pasur fare interesim të hetojnë krimet që i kanë bërë në Kosovë "Shqiptonjat e Bardha" të Vojislav Sheshelit por kanë shfaqur interesim ekstrem për "Shqiptonjat e Zeza të Dukagjinit".

Për Gjykatën që do të gjykonte krimet e luftës në Kosovë pavarësisht përkatësisë etnike dhe të tjera, patëm diskutuar në Kryesinë e KMDLNj-së kurse, më shumë kemi qenë të involvuar në këtë çështje; Pajazit Nushi, Ibrahim Makolli dhe unë. Ndërkombëtarët, si mospërfillës që ishin thoshin se; "për raste të krimeve të luftës janë kompetente gjykatat në Kosovë, 100 për qind në përbërje ndërkombehtarë kurse për rastet më të ndjeshme është Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë për ish-Jugosllavinë në Hagë...". Të gjithë jemi dëshmitarë të dëshimitit të turpshëm të Tribunalit të Hagës, si Gjykatë e nënshtruar ndaj politikës dhe dështimeve me qëllim të gjykatave të UNMIK-ut dhe EULEX-it, një pjesë e të cilëve Kosovën e kanë shndërruar në një mundësi të hatashme të pasurimit, qoftë përmes montimit të proceseve gjyqësore, qoftë përmes shitjes së pafajësisë personave me një të kaluar dhe të dëshmuar kriminale. Se kishte ndikim politik në Tribunalin e Hagës e dëshmon Lujz Arbur, kryeprokuroja e parë e këtij Tribunali sikur edhe prokurorë dhe gjykatës të tjerë, pasi janë larguar nga ky Tribunal! Se kishte shpërdorim të detyrës zyrtare në fushën e drejtësisë nga ndërkombehtarët në Kosovë, nuk e them unë por se këtë e kanë thënë shumë prokurorë, hetues apo gjykatës ndërkombehtarë, gjithashtu pasi janë dorëhequr apo e kanë humbur vendin e punës në këtë mision të përfshira në shumë aktivitete kriminale.

**Dhomat e Specializuara apo Dhomat e Gazit për ushtarët dhe eprorët e UÇK-së:** Pasi, kryesisht për arsye të oportunitetit politikë qëllimisht dështojë i tërë zinxhiri i "drejtësisë" në Kosovë (UNMIK dhe EULEX, si bastard i UNMIK-ut) në me krye me Tribunalin e Hagës, ndërkombehtarët, për të hapur vende të reja të punës dhe për të imponuar zgjidhje politike për marrëveshje me Serbinë, e sajuan një monstrum juridik të cilin e mbështolën me një qulaf vendor në formën e Dhomave të Specializuara e që qenkan pjesë e sistemit të drejtësisë të Kosovës. Për të besuar këtë, sa paku duhet të jeni idiot apo duhet t'ua kenë zënë fort bishtin me derë, siç thuhet në popull. Një Kuvend i nënshtruar një presioni të hatashëm në mesin e të cilëve ka të tillë që: "për shkak të urrejtjes ndaj UÇK-së, edhe nëse nuk do të kishte një Gjykatë të tillë, do të duhej të shpikjej sikur edhe një pjesë e krahut të luftës që fort iu



ishite zënë bishti me derë..." prandaj thoshin se kjo është për të mirën e Kosovës dhe idiotësira të ngjashme. Gjithashtu, thoshin se kjo Gjykatë është projekt ndërkombëtar dhe në veçanti amerikan e që e ka për qëllim ta pastrojnë luftën e UÇK-së përmes marrjes në pyetje të 7-8 personave dhe këtu çdo gjë pastaj merr fund! Merreni me mend; të besoni se një Gjykatë me një buxhet prej 300 milionë eurosh do të trajtojë vetëm 7-8 raste, hajt thoni tani se jemi normalë! Kuvendi i Kosovës, në rrethana të shtetrrrethimit e ka votuar këtë Gjykatë dhe duket se më entuziastë ishin ata që luftuan dhe bënë shumë sakrificë për këtë vend! Tash, një numër jo i vogël i tyre, posa ta sheh një veturë të EULESH-it apo ndonjë zyrtarë me letra në dorë, pshurren në brekë duke thënë: "Inshallah jam në ëndërr dhe inshallah nuk janë për mua por... për Behxhetin...". Lufta e UÇK-së ka qenë luftë tipike çlirimtare dhe e drejtë por që nuk nënkupton se nuk mund të ketë bërë ndonjë ushtar apo eprorë ndonjë vepër që është në kundërshtim me ligjet e luftës dhe të drejtën humanitare. Se duhet të dënohen të gjithë ata që iu dëshmohet përfshirja në krime të luftës, nuk diskutohet dhe nuk mund të kundërshtohet. Në rastin e Kosovës kemi të bëjmë me një drejtësi dhe padrejtësi selektive ku ndiqet vetëm njëra palë ndër-luftuese (shqiptarët) kurse falet pala tjetër që ka bërë krime deri në gjenocid në Kosovë (shteti serb). Gjithashtu, kjo Gjykatë siguron drejtësi vetëm për viktimat e përkatësisë etnike serbe kurse krejtësisht injorohen viktimat e palës shqiptare e që përbëjnë 97 për qind të viktimave të luftës. Kuvendi i Kosovës është dashur ta refuzojë këtë model të Gjykatës që paragjykon fajësinë apo pafajësinë sipas parimit etnik duke kërkuar drejtësi dhe përgjegjësi për të gjithë, pavarësisht përkatësisë etnike, racore, besimit dhe statusit në shoqëri. Kjo Gjykatë në mënyrën më brutale e dhunon parimin e universalitetit të drejtave të njeriut duke garantuar të drejta të njeriut dhe drejtësi ekskluzivisht në baza etnike. Çka ka arritur kjo Gjykatë raciste deri më tani? Ka përçarë faktorin politikë në Kosovë, ka premtuar pritje të mëdha për të viktimizuarit dhe familjarët e tyre duke premtuar drejtësi e që nuk do ta bëjë duke mos dalë nga kornizat e raportit të Dik Martit!

Po i poshtëron skajshmërisht

avokatët e Kosovës, sidomos shteti i Holandës që nuk ua lëshon vizat me kohë apo ua lëshon vetëm për një seancë duke i detyruar të përsëritjen e procesit terrorizues siç është aplikimi për një vizë. Nuk ua njeh statusin profesional dhe diplomatik apo zyrtarë dhe gjatë kontrollave në kufij i trajton sikur të ishin kontrabandues të narkotikëve nga Lazarati!

Lufta për liri dhe çlirim është e drejtë njerëzore, e drejtë morale, e drejtë ligjore ndërkombëtare dhe e drejtë e mbijetesës. Si e tillë duhet të përkrahet, ata që e bënë luftën duhet të respektohen dhe nderohen përjetësisht, nëse u janë përmbajtur parimeve të një lufte, sipas zakoneve të luftës. Këta që sot po thirren në Hagë dhe mbase disa nuk do të kthehen, e sollën lirinë edhe për denoncuesit e tyre, edhe për ata që na dhunuan për vite të tëra në emër të vëllazërim - bashkimit dhe Jugosllavisë socialiste, në emër të ruajtjes së bashkëjetesës midis xhelatit dhe viktimës. Këta që po thirren në Hagë, gjatë luftës ishin luftëtarë të Adem Demaçit dhe Adem Jasharit të cilët nuk pyetën se çfarë çmimi duhet të paguajnë për liri sepse liria nuk ka çmim! Shiheni Kosovën sot, e mbjell me varre të civilëve shqiptarë të ekzekutuar nga forcat serbe (të pandëshkuara për krime) dhe ushtarët si dhe eprorët e të lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Atyre u takon lavdia e përjetshme kurse qyqarëve kjo jeta mjerane që e bëjnë. Viktimat dhe heronjtë respektohen, të pafytyrët gjithmonë kujtohen, si pleh dhe si mish i keq i trungut kombëtar! Këta që sot po bëjnë Gjykata që ndanë drejtësi në baza etnike, jo fort moti (lufta e dytë botërore) ekzekutonin femra dhe gra shtatzëna pse ishin të lidhura me armikun. Mos të flasim për ata që bashkëpunonin me okupatorin, fati i tyre dihej! A ishte formuar ndonjë Gjykatë Speciale për ta? Jo dhe jo! T'i mëshojmë pakëz ndërgjegjes nëse e kemi; ta vendosim veten në vendin e tyre që më shumë se 20 vite nuk kanë asnjë informatë për të dashurit e tyre që janë të zhdukur, pavarësisht përkatësisë etnike, para se t'i duartrokasim një Gjykate raciste dhe para se të gëzohemi apo më mirë të them të hidhërohem pse ende nuk kanë filluar gjykimet dhe pse nuk janë mbushur qeliet e këtij burgu me ata që luftuan dhe bënë sakrificën sublimë! E kam fjalën për ata që janë të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm!

## Haradinaj thotë se Kosova duhet të krijojë zonë të veçantë ekonomike zvicerane

PRISHTINË, 20 JANAR (ER) - "Kosova dhe Zvicra suksesshëm kanë arritur të mbajnë dhe avancojnë marrëdhënie të shkëlqyera ekonomike dhe politike", kështu tha kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në takim me Stefan Sarkany, president i Dhomës së Tregtisë, Industrisë dhe Shërbimeve Zvicër -Kosovë. Më tej, kryeministri në detyrë, Haradinaj, tha se pas vendimit për Zonën e Veçantë Ekonomike Amerikane dhe Parkun Inovativ Trajnues Kosovaro-Gjerman, është koha e krijimit të Zonës Ekonomike Zvicerane, me qëllim të shtimit të bashkëpunimit ekonomik dhe partneritetit mes dy vendeve, për të cilën ide do të nisin përgatitjet e nevojshme.

Gjatë takimit u bisedua edhe për krijimin e hapësirës së përfaqësimit të diasporës tonë në Zvicër, në Parlamentin e Kosovës, si një veprim i duhur dhe i nevo-



jshëm. "Zvicra është një nga vendet mike të Kosovës që ka ndihmuar shumë në shtetkrijim dhe shtetndërtim dhe tani ky raport duhet të avancohet në marrëdhënie konkrete, profesionale bilaterale, në të mirë të ekonomisë së vendit dhe diasporës sonë", tha kryeministri në detyrë Haradinaj.

Kryeministri në detyrë, Haradinaj, vlerësoi se është me rëndësi që të shtohet bashkëpunimi ekonomik

ndërmjet dy vendeve tona përmes aktiviteteve konkrete që ndihmojnë në zhvillimin ekonomik. "Kosova ka krijuar klimë të mirë për investimet e huaja direkte, pasi ka miratuar edhe Ligjin për Investime Strategjike", tha Haradinaj, duke ftuar investitorët zviceranë, po ashtu edhe afaristët shqiptarë, që aktivitetin e tyre biznesor e ushtrojnë në Zvicër, që të investojnë në Republikën e Kosovës.

## Përurohet objekti administrativ i njësisë operative të ujësjellësit në Drenas

Drenas, 20 janar (ER) - Në Komunën e Drenasit është përuar objekti i njësisë operative të ujësjellësit. Në këtë ceremoni morën pjesë kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, bordi i drejtorëve i KRU "Prishtina" sh. a. i kryesuar nga Betim Berisha, kryeshefi ekzekutiv Ilir Abdullahu, zyrtarët e lartë të kompanisë dhe punëtorë të tjerë.

Ndërtimi i objektit administrativ të ujësjellësit në Drenas është bashkëfinansim i KRU "Prishtina" sh.a. dhe Komunës së Drenasit. Kostoja e këtij projekti është rreth 100 mijë euro, mjete financiare të ndara nga KRU "Prishtina" sh.a., derisa Komuna e Drenasit kishte ndarë parcelën për ndërtim. "Ky objekt administrativ është ndërtuar në një lagje të kësaj komune, konkretisht në 'Drenasi III'. Objekti i ndërtuar tashmë do të jetë në shërbim të qytetarëve të kësaj komune, aty ku mund të bëhen ankesa dhe kërkesa komerciale dhe teknike, pagesa për shërbime të ujësjellësit



dhe kanalizimit, pra gjithçka që ndërlidhet me shërbimet e ofruara për të gjithë konsumatorët", thuhet në njoftimin e KRU "Prishtina".

Sipas këtij njoftimi, Zyra Qendrore e Ujësjellësit në Komunën e Drenasit për pagesa të shërbimeve mbetet sërish aty ku ka qenë, në qendër të kësaj komune. "Jua kujtojmë se Kompania Rajonale e Ujësjellësit 'Prishtina' sh.a. ofron shërbime të ujit dhe kanalizimit edhe në Komunën e Drenasit, qytetin dhe disa zona përreth. Në Drenas u ofrohen shërbime 5 156 konsumatorëve.

Në këtë komunë kemi një shtrirje të gjerë të infrastrukturës së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, 115 kilometra rrjet ujësjellësi dhe 34 kilometra rrjet të ujërave të zeza. Zonat ku ne ofrojmë shërbime janë: Drenasi (qyteti), Pokleku i Ri, Pokleku i vjetër, Shtrubullova, Gllolari, Tersteniku, Çikatova, Dobrosheci, Gllanasella, Komorani dhe Zabeli i Lartë. Në këtë komunë kemi tre rezervuarë të ujit dhe dy stacione te pompave, ku uji fillestar merret nga kanali i Ibër Lepencit në fshatin Bivolak", është bërë me dije në njoftimin e KRU "Prishtina".

## Thaçi merr pjesë në Forumin Botëror Ekonomik të Davosit

Prishtinë, 20 janar (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të hënë ka udhëtuar për në Zvicër, ku do të marrë pjesë në Forumin Botëror Ekonomik të Davosit.

Presidenti Thaçi nesër do të jetë pjesëmarrës në panelin "Dialogu

diplomatik për Ballkanin Perëndimor" dhe gjatë ditës do të ketë takime bilaterale edhe me liderë të ndryshëm shtetesh që po marrin pjesë në këtë forum.

Presidenti Thaçi do të jetë i pranishëm edhe në adresimin e Presidentit të Shteteve të

Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, drejtuar liderëve të të gjitha vendeve pjesëmarrëse. Po ashtu, presidenti Thaçi do të marrë pjesë edhe në darkën zyrtare të shtruar nga organizatorët e Forumit Botëror Ekonomik për udhëheqësit e shteteve në Davos.



## Haskuka zotohet se do të jetë në shërbim të prizrenasve

PRIZREN, 20 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, në takim të organizuar me qytetarë në sallën e Kuvendit Komunal, ka prezantuar raportin e punës për vitin 2019. Në këtë takim të pranishëm kanë qenë rreth 80 pjesëmarrës,

përfshirë këtu edhe kryetarë të bashkësive lokale, përfaqësues të organizatave të ndryshme, përfaqësues të mediave dhe qytetarë të shumtë. Haskuka ka thënë se për vitin 2019 është bërë punë e madhe në fusha të ndryshme në Prizren, ndërsa ka premtuar se

gjithmonë do të jetë në shërbim të qytetarëve. Pas prezentimit të raportit, fjala u është dhënë të pranishmëve të cilët ngritën çështje të ndryshme, ndërsa përgjigjet i morën nga ana e kryetarit dhe drejtorëve komunalë.



## Ndërron jetë ish-kryetari i Kuvendit Komunal të Rahovecit



RAHOVEC, 20 JANAR (ER) - Ka ndërnuar jetë ish-kryetari i Kuvendit Komunal të Rahovecit, Esat Haxhijaha. Lajmin e ka bërë me dije kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi. "Sot u nda nga jeta një nga personalitetet e rëndësishme në Rahovec e më gjerë, z. Esat Haxhijaha. Ai dha kontribut të dukshëm për disa dekada në proceset edukative, politike, ekonomike dhe shoqërore. Ishte kryetar i Kuvendit të Komunës së Rahovecit që barti mbi supë përgjegjësi dhe kreu shumë

detyra në shërbim të komunës dhe popullit të kësaj treve", ka thënë Latifi.

Më tutje, Latifi ka thënë se Haxhijaha do të mbahet mend për zhvillimin e Komunës së Rahovecit. "Esat Haxhijaha në kujtesën tonë mbetet një njeri i mirë dhe me ndikim të madh në popull, i dashur, intelektual i çmuar, një shqiptar i mirë që i dha vendit dhe përpjekjes sonë për liri një kontribut të veçantë, për ç'gjë edhe u burgos nga Serbia. Ai do të mbahet gjatë në mend për kontributin e tij në zhvillimin dhe për-

parimin e Komunës së Rahovecit, arsimimin dhe edukimin e brezave. Komuna jonë dhe qytetarët tanë sot dhe në të ardhmen shprehin vlerësimin, mirënjohjen dhe respektin më të lartë ndaj z. Esat Haxhijaha. Në këtë moment dhembjeje e pikëllimi, me rastin e vdekjes së bacës Esat, në emër të të gjithë qytetarëve të Komunës së Rahovecit dhe në emër timin, familjes Haxhijaha, farefisit, miqve dhe bashkëpunëtorëve ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta! Pusho në paqë! Ngushëllime!", ka theksuar Latifi.

## Vihet gurthemeli për ndërtimin e 44 shtëpive në fshatin Frashër të Mitrovicës

MITROVICË, 20 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me drejtorin e organizatës "Qatar Charity", Muhamoud Abbas Shkaer, kanë vënë të hënën gurthemelin për ndërtimin e 44 shtëpive, një shkolle, një shtëpie të shëndetit, katër lokaleve afariste, një objekti të destinuar për shfrytëzim nga "Qatar Charity" dhe një xhamie për familjet në nevojë, në fshatin Frashër të Mitrovicës.

Në vënie e gurthemelit ishin të pranishëm nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, drejtori për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Besnik Beka, drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Hysen Muzliukaj, si dhe përfaqësues nga organizata "Qatar Charity". Me



këtë rast kryetari Bahtiri ka falënderuar përfaqësuesit e "Qatar Charity" për mbështetjen e tyre të vazhdueshme ndaj Komunës së Mitrovicës, duke sjellë projekte madhore në sektorë të ndryshëm,

për ta përmirësuar cilësinë e jetesës së qytetarëve tanë. "Ky projekt i mbështetur nga organizata juaj është shumë i rëndësishëm si në aspektin ekonomik, po ashtu edhe në atë social por,

mbi të gjitha, ka vlera humanitare sepse u atribuohet qytetarëve të cilët jetojnë në kushte jo të mira ekonomike. Dhe ne ndihemi shumë falënderues për mbështetjen e vazhdueshme dhe

realizimin e shumë projekteve në qytetin tonë, kur dihet se aktualisht qyteti i Mitrovicës përballet me vështirësi të mëdha ekonomike", tha ndër të tjerash Bahtiri.

Ndërsa drejtori i organizatës "Qatar Charity", Muhamoud Abbas Shkaer, theksoi se ata do të vazhdojnë edhe në të ardhmen t'i ndihmojnë qytetarët e Mitrovicës me projekte të ndryshme, e veçmas ato familje që me të vërtetë kanë nevojë.

Ky projekt realizohet nga bashkë-financimi i Komunës së Mitrovicës dhe organizatës "Qatar Charity", me ç'rast Komuna e Mitrovicës do të participojë me mjete financiare në shumën totale prej 760,000.00 eurosh si dhe ka siguruar pronën komunale për ndërtimin e të gjitha shtëpive për familjet në nevojë.

## Vitia së shpejti do të bëhet me muze komunal

VITI, 20 JANAR (ER) - Komuna e Vitisë do të bëhet me muze komunal pasi të hënën kanë filluar punimet në rregullimin e objektit të vjetër ku dikur gjendej Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe e Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë e cila, pas rregullimit, do të dedikohet për këtë qëllim.

Kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, ka thënë se është shumë e rëndësishme që në qendër të qytetit ta kenë një

muze, "me qëllimin më të mirë që qytetarët dhe vizitorët të njihen me të kaluarën e vendit tonë. Fatmirësisht, falë bashkëfinancimit tonë me Bashkimin Evropian kjo do të realizohet së shpejti pasi që sot vetëm se kanë filluar punimet për rregullimin e objektit", ka thënë Haliti.

Ndërsa Alban Morina, menaxher i projektit, ka thënë se financimi për rregullimin e objektit do të bëhet nga Bashkimi Evropian dhe Komuna e Vitisë në dy faza. Ai

ka theksuar se ky projekt do të zbatohet nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosova) në kuadër të Nismës për Bashkëpunim Ndërkufitar (MAKS FORUM). Në anën tjetër, Milot Lala, drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, ka falënderuar Bashkimin Evropian që do ta bashkëfinancojë këtë projekt me Komunën e Vitisë. Vlera e këtij projekti do të jetë rreth 30 mijë euro, ku Komuna e Vitisë dhe BE-ja do të kontribuojnë me nga 15 mijë euro.



Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (6)

# Fusha e realët magnetike e magnetit



**Shkruan: Naim  
KRASNIQI, fizikan**

**Argumenti i parë përfundimtar**  
Prandaj bazuar në analizat eksperimentale të eksperimenteve të deritanishme të cilat janë shumë të thjeshta, dhe lehtë për t'u kuptuar e vënë në dyshim të kuptuarit e fushës magnetike. Realisht një formë simetrie të valëve të fushës magnetike në asnjërin nga eksperimentet nuk mund të arrihet përmes procesit se si mendohet që buron fusha magnetike vetëm nga poli magnetik i veriut (N), dhe pasi bënë një rrugë kthehet dhe hyn në polin magnetik i jugut (S), e pastaj vazhdon drejt polit magnetik të veriut, duke vazhduar në të njëjtën mënyrë.

**Argumenti i dytë përfundimtar**  
Por i vetmi realitet që mund të vërehet nga analizat eksperimentale, është se fusha magnetike merr një formë simetrie mbi të dy polet e magnetit, atëherë dhe vetëm atëherë kur fusha magnetike buron njëkohësisht nga të dy polet e një magneti. Prandaj siç po shihet bazuar në ligjet e natyrës vërtetohet se fusha magnetike absolutisht nuk është një fushë që buron nga poli magnetik i veriut (N) dhe hynë polin magnetik të jugut (S), Por fusha magnetike te magnetët buron njëkohësisht nga të dy polet e magnetit (N) dhe (S). Fusha magnetike që buron nga të dy polet e një magneti quhet fusha magnetike simetrike. Por një fushë e vetme nuk mund të buroi nga të dy polet e një magneti apo elektromagnetit, kështu që përfundimisht themi se, nga polet magnetike të secilit magnet burojnë njëkohësisht dy fusha magnetike simetrike. Por bazuar në të dhënat e mëparshme se nga secili pol magnetik fig 3e burojnë njëkohësisht nga dy fusha magnetike vijnë te përfundimi i fushës magnetike simetrike.

## Fusha magnetike simetrike

Ligji i fushës magnetike simetrike  
Fushat magnetike simetrike janë ato fusha të cilat burojnë njëkohësisht nga të dy polet magnetike

(?) dhe (?) të një magneti, ku secila fushë magnetike e secilit pol magnetik në brendinë e saj mbanë nga dy fusha magnetike figura 7. Për dallim nga rastet e zakonshme që poli magnetik i veriut shënohet me (N) nga ku mendohet se buron fusha magnetike, kurse poli magnetik i jugut me (S) ku mendohet se hyn fusha magnetike, këtu për të daluar se nuk kemi të bëjmë me pole magnetike sikur te fusha magnetike normale, por kemi të bëjmë me fusha magnetike simetrike: 1. (?) Fusha magnetike simetrike e polit të parë magnetik dhe 2. (?) Fusha magnetike simetrike e polit të dytë magnetik.

## Bartëset e fushave magnetike simetrike

Meqenëse fushat simetrike burojnë nga të dy polet e një magneti, kjo na japë për të kuptuar se nuk kemi të bëjmë me një fushë magnetike që mendohej se del nga poli i veriut (N), dhe hynë në polin e jugut (S), ku bartëset të kësaj fushë ishin momentet magnetike të elektroneve, që janë sikur grimca elementare magnetike. Kurse pasi këtu në rastin e dytë kemi të bëjmë me dy fusha magnetike që burojnë njëkohësisht nga të dy polet magnetike (?) dhe (?) të një magneti, me siguri se ndryshojnë edhe bartëset e këtyre dy fushave magnetike simetrike të cilat do të sqarohen më vonë në këto botime. Sqarim i parë. Fluksi i fushave magnetike ka një ndryshim të vlerës në mes poleve magnetike, por pasi ky ndryshim i vlerës së fluksit magnetik nuk është i madh në të shumtën e rasteve, ne e marrim fluksin magnetik si të barabartë, edhe pse me kohë do të sqarohet se pse paraqitet ky ndryshim.

Sqarim i dytë. Për dallim nga botimet e korrikut (Krasniqi 2019) në eksperimente përdorej fusha magnetike që matej me tesla (T). Në këto botime tani do të përdoret fluksi magnetik me njësinë weber për ta kuptuar ma thjeshtë.

Sqarim i tretë. Magneti simetrik quhet magneti që ka formën e një cilindri Për t'i ndërlidhur proceset eksperimentale ne do t'i kthehemi edhe një here eksperimentit të dytë, (i botuar në "Epoka e re" 2019) figura 8.

Në atë eksperiment ishte sqaruar se kur polet e një magneti cilindrik (M) mbyllet me pllaka të hekurit (a) dhe (b) kemi një rritje të fluksit të fushës magnetike ? NS




Fig. 7




Fig. 8




Fig 9




Fig.10

në të dy polet e magnetit (M). Kurse nëse i referohemi fluksit të fushës magnetike vetëm mbi polet e magnetit pa prezencën pllakave të hekurit (a) dhe (b), fluksi i fushës magnetike ? NS kishte vlerën ?NS=1.56 x 10<sup>-4</sup> Wb. Mirëpo pasi polet magnetike të magnetit si i veriut (N) ashtu edhe i jugut (S) mbulohej me pllaka të hekurit (Fe) eksperimentalisht vërtetohet se rritet fluksi i fushës magnetike për 57 për qind nga vlera ?NS=1.56x10<sup>-4</sup> Wb. Në vlerën e ?N=2.45x10<sup>-4</sup> Wb. Kurse fluksi që buron nga pllaka e magnetizuar (N') mbi polin mag-

netik(N) kishte vlerën në të dy anët e pllakave të hekurit ?N'=3.74x10<sup>-5</sup> Wb. Nëse krahasohen me fluksin e fushës magnetike mbi polet e magnetit shihet se kemi një zbritje të vlerës për 84,73 për qind. Këto të dhëna eksperimentale nuk kanë asgjë të përbashkët me fushat magnetike që sqarohen nga fizika e tanishme. Kjo rritje e fluksit të fushës magnetike ? NS mbi polet magnetike (N) dhe (S) të magnetit cilindrik (M) kur vendosen pllakat e hekurit (Fe) mbi polet magnetike asnjëherë nuk i ka hetuar fizika e deri më

tani askush. Mirëpo tani pas zbulimit të fushës magnetike simetrike eksperimentin e njëjtë që ishte botuar në "Epoka e re", e modifikojmë me simbole të fushës magnetike simetrike.

## Të panjohurat e fushës magnetike të eksperimentit të dytë

Eksperimenti i dytë i botuar në korrik 2019 në epoka e re, nga një fushë magnetike normale që ishte paraqitur më parë, tani e transformojmë në një fushë magnetike simetrike ashtu sikur e kam paraqitur ekzistimin e fushës magnetike simetrike. Kurse për ta kuptuar ma thjeshtë elementet që marrin pjesë në këtë eksperiment i ndajmë, por sido që të jetë kjo ndarje e këtyre elementeve ndodhen brenda një sistemi të mbyllur, shih figurën 9. Në procesin eksperimental të këtij sistemi të izoluar marrin pjesë të njëjtat elemente ashtu sikur është sqaruar në eksperimentin e dytë i botuar më 19/20 korrik 2019: - Një magnet cilindrik (M) me polet e magnetike (?) dhe (?); - Nga polet e magnetit (?) dhe (?) burojnë flukse te fushave magnetike simetrike (?) dhe (?) ku vlerat e tyre janë ??=1.56x10<sup>-4</sup> Wb dhe ??=1.56x10<sup>-4</sup> Wb; - Një masë prej 225 gramëve e varur përmes litarit në mesin e magnetit, me një forcë tërheqëse që vepron në mes tyre në vlerën e 2,2 N si dhe - dy pllaka (a) dhe (b) të hekurit (Fe) të pa magnetizuara, që fluksi i fushës magnetike e ka vlerën e (0) Wb.

Sqarim: Fusha magnetike është një formë e energjisë, prandaj kur kemi të bëjmë me energji të fushave magnetike, këtu hyjnë të gjitha llojet e fushave, qoftë fushave magnetike dhe anti-magnetike.

Eksperimentalisht vërtetohet se vlera e fluksit të përgjithshëm të fushave magnetike (?) dhe (?) që buron nga polet e magnetit (?) dhe (?) nëpër këtë sistem të izoluar është i barabartë me vlerat ??1?2= 3.12x10<sup>-4</sup> Wb. Meqenëse edhe pllakat e hekurit (a) dhe (b) që janë të magnetizuara bëjnë pjesë brenda këtij sistemi të mbyllur, i vendosim mbi polet magnetike simetrike (?) dhe (?). Kuptohet se pllakat e hekurit (a) dhe (b) magnetizohen pasi të vendosen mbi polet e magnetit cilindrik, me ç'rast krijohen polet magnetike (?') dhe (?'') të pllakave të hekurit (a) dhe (b) ashtu sikur shihet në figurën 10. (VIJON)

Flet Daut Dauti

# KRIJIMI I SHQIPËRISË NË LONDËR SI REZULTAT I NJË KOMPROMISI TË FUQIVE TË MËDHA (4)

**Intervistoi: Haqif MULLIQI**  
**Fotografinë: Agron SHALA**

*Sipas britanikëve, cilat ishin marrëdhëniet e pushtetit otoman me Lidhjen e Prizrenit?*

DAUTI: Raportet e konsujve britanikë për Lidhjen e Prizrenit nga terreni kanë qenë konfliktuozë. Konsulli i përhershëm Green nga Shkodra dhe ai i përkohshëm nga Prizreni, St. John, nuk ishin në favor të çështjes shqiptare. Green kishte rënë nën ndikimin e konsullit austro-hungarez, Lipitch, i cili kishte prejardhje sllave, kurse St. John vepronte nën ndikim të konsullit rus. Që të dy i quanin udhëheqësit e Lidhjes prijës të fiseve. Qëllimi i tyre ishte që shqiptarët të paraqiteshin si njerëz të paorganizuar dhe të cilëve kinse u mungonte vetëdija kombëtare. Lidhja e Prizrenit për ta ishte organizatë religjioze fanatike (myslimane) e themeluar nga sulltani (Abdyl Hamiti) për t'i kundërshtuar vendimet e Kongresit të Berlinit dhe për t'i persekutuar të krishterët. Shumica e raportimeve të këtyre dy konsujve për Lidhjen janë të errëta. St. John vazhdimisht shkruante se Lidhja e Prizrenit do t'i masakronte të krishterët, por nuk gjeti asnjë shembull për ta ilustruar parashikimin e tij qëllimkeq ndaj shqiptarëve. Konsulli Green në Shkodër në disa raste i këshillonte gazetarët britanikë që të mos shkonin në Prizren për shkak se jeta e tyre do të ishte në rrezik. Realiteti ishte ndryshe dhe gjatë kohës së Lidhjes, e cila veçoi si një qeveri me përvojë, vilajetet shqiptare funksionuan më mirë sesa nën sundimin otoman.

Këtë situatë e shpalosën mirë diplomatët britanikë në Stamboll që kishin rang më të lartë se St. John dhe Green. Ambasadori Layard dhe, më vonë edhe Fitzmaurice, që të dy diplomatë të njohur dhe me njohuri të madhe për Ballkanin dhe Perandorinë Otomane, së bashku me disa diplomatë të tjerë, disa herë i shkruan Foreign Office-it që të mos i merrnin parasysh raportet e këtyre dy konsujve që dërgoheshin nga Shkodra dhe Prizreni për shkak se nuk e paraqitnin situatën ashtu siç ishte. Për këtë arsye Fitzmaurice hartoi një raport special. Ky e shpjegonte Lidhjen e Prizrenit si një organizatë nacionaliste e cila kishte kërkesa të njëjta me ato të kombeve të tjera të Ballkanit. Diplomatat në Stamboll, Lidhjen e Prizrenit e shihnin me sy të mirë dhe i arsyetonin kërkesat e saj. Madje këta diplomatë dolën me kërkesë drejtuar Londrës, se shqiptarët duhej të akomodoheshin në një shtet autonom nën Portën e Lartë që do të shërbente si një bërthamë e shtetit të pavarur shqiptar.

*Kur filloi ndryshimi i qëndrimit diplomatik dhe politik britanik ndaj çështjes së territoreve otomane në Ballkan?*

DAUTI: Sa ishin konservativët në pushtet, të udhëhequr nga Disraeli, Londra e njëjta Lidhjen e Prizrenit si organizatë që përfaqësonte kërkesat e shqiptarëve. Sekretari i jashtëm britanik, Lordi Salisbury, më 12 maj 1879 i kishte pritur zyrtarisht në Foreign Office dy delegatët e Lidhjes së Prizrenit, Abdyl Frashërin dhe Mehmet Vrionin. Madje, Salisbury i këshilloi Frashërin dhe Vrionin se çka duhej të bënte Lidhja në të ardhmen. Ky ishte një veprim të cilin e kritikoi ashpër opozita, gjegjësisht liberalët. Ata mendonin se qeveria britanike do të duhej të sillej me përfaqësuesit e Lidhjes njësoj sikur kancelari gjerman, Bizmarku, i cili nuk i pranoi në takim.

Mirëpo, gjërat ndryshuan në vitin 1880 kur në pushtet erdhën liberalët e udhëhequr nga William Gladstone (1809-1898), i cili, me doktrinën e vet liberale, u jepte të drejtë dhe hapësirë rusëve që të përziheshin në Ballkan dhe në territoret e tjera otomane ku jetonin të krishterët. Gladstone ishte religjioz dhe i favorizonte të krishterët. Ardhja e tij në pushtet ishte shenjë e ngufatjes së një klime të përshtatshme për shqiptarët që në Britani ishte themeluar nga Lord Byroni e që ishte vazhduar nga Disraeli, Urquhart dhe disa personalitete të tjera. Gladstone e themeloi një politikë të jashtme nga e cila më vonë do të përfitonin Serbia, Mali i Zi dhe Greqia.

Me ardhjen e Gladstoneit në pushtet, shqiptarët, por më shumë Porta e Lartë, patën arsye që të frikoheshin. Frika u shtua kur ambasadori Layard, i cili njëherë për qëndrim pozitiv ndaj çështjes shqiptare dhe pushtetit otoman dhe që urrehej nga liberalët, u zëvendësua me Joachim Goschenin. Lordi Fitzmaurice u dërgua në Stamboll për mbikëqyrje të reformave. Por, ndodhi një befasi. Goschen dhe Fitzmaurice u angazhuan edhe më shumë në dobi të çështjes shqiptare. Këta dy, udhëheqës të diplomacisë britanike në Stamboll, krijuan mendimin për themelimin e shtetit shqiptar. Megjithatë, në Londër, kryeministri Gladstone kishte mendim tjetër. Tekefundit, Gladstone nuk kishte presion nga opinioni publik që të vepronte sipas propozimeve të diplomatëve të tij që i kishte dërguar në Stamboll. Për këtë arsye, iniciativa e themelimit të bërthamës së shtetit shqiptar gradualisht u shua.

*Zoti Dauti, të kthehemi edhe një herë te ngjarjet e vitit 1877 në Vilajetin e Shkodrës dhe te përcaktimi i kufirit me Malin e Zi.*



*Cilat ishin aktivitetet ushtarake dhe diplomatike të Malit të Zi dhe rezistenca e shqiptarëve për mbrojtjen e territorit të tyre në këtë periudhë?*

DAUTI: Forcat ushtarake otomane nuk ofruan rezistencë të denjë ndaj sulmeve malazeze. Territori otoman, i cili, në fakt, ishte i banuar me shqiptarë, binte lehtë në duar të ushtrive serbe dhe malazeze. Kjo ishte brengosëse për shqiptarët. Kjo ishte arsye që shqiptarët filluan të vetorganizoheshin pasi që Porta e Lartë nuk u dilte zot tokave shqiptare. Lidhja e Prizrenit ishte formuar edhe si rezultat i frikës që krijoi dështimi i Portës. Organizimi i Lidhjes ka qenë i shkëlqyeshëm. Lidhja, e cila e anuloi sundimin otoman, veçoi si një qeveri e mirëfilltë. Organizimi i saj u pa në fushën ushtarake. Kur shqiptarët e morën në dorë mbrojtjen e kufirit gjërat ndryshuan. U krijua një ushtri shqiptare e fuqishme pasi që të gjithë ushtarët shqiptarë, sidomos oficerët, dezertuan nga njësitë otomane dhe iu bashkuan forcave të Lidhjes. Kjo ushtri, e komanduar nga Ali Pashë Gucia, e ndaloi procesin e demarkimit të kufirit apo kalimin e territoreve shqiptare në përbërje të Malit të Zi. Brenda një kohe të shkurtër forcat e Lidhjes u bënë kërcënim serioz për Malin e Zi. Ushtria malazeze disa herë provoi që të hynte në Plavë e Guci, por pësoi debakël. Nga raportet që dërgonin konsujt britanikë në Londër bëhej me dije se princ Nikolla frikësohej seriozisht që këto forca shqiptare mund edhe ta okuponin Malin e Zi. Frika e princit malazet ishte e arsyeshme. Por, si duket forcat shqiptare nuk e kishin të qartë se sa të fuqishme që ishin. Mbrojtja vetëm e territoreve që Berlioni kishte urdhëruar t'i dorëzoheshin Malit të Zi, ka qenë gabim. Forcat shqiptare është dashur të sulmonin dhe të depërtonin deri në Cetinë pasi që kjo punë ishte e mundshme dhe do ta kishte ndryshuar të ardhmen e këtyre dy vendeve.

*Sa reflektonte situata, në këtë kohë, në qeverisjen qendrore otomane dhe reflektimi i saj në çështjen shqiptare?*

DAUTI: Nga korriku i vitit 1878 sundimi otoman në vilajetin e Kosovës dhe atë të Shkodrës praktikisht nuk ka ekzistuar për shkak se qeverisja ra në duar të Lidhjes së Prizrenit. Kjo ishte një situatë që i konvenonte Portës së Lartë për shkak se qeverisja qendrore ishte në favor të ruajtjes së territorit otoman, pjesë e së cilës ishin vilajetet shqiptare. Por, ky qëndrim i pushtetit otoman ndryshoi kur Lidhja u forcua aq shumë sa që situata shkoi në drejtim të krijimit të shtetit shqiptar që nënkuptonte zvogëlimin e territorit otoman dhe zhdukjen e pranisë së Perandorisë Otomane në Evropë. Pastaj, situata ndryshoi edhe më shumë kur vendimet e Kongresit të Berlinit, në fakt, nuk u zbatuan dhe Fuqitë e Mëdha u detyruan që të mblidheshin edhe një herë në Konferencën e Berlinit dy vjet më vonë (1880). Gladstone, pa kompromis, filloi t'i bënte presion sulltanit që t'i dorëzonte territoret. Ky ishte momenti kur forcat e Lidhjes dhe ato të Portës u detyruan që të ndesheshin ushtarakisht në shumë raste. Sulltani u detyrua ta shuante Lidhjen e Prizrenit duke marrë masa drastike.

*Çfarë pasojë patën shqiptarët nga vendimet e Konferencës së Shën Stefanit dhe tendencat e disa fuqive për të ushtruar influencë në Shqipëri dhe cilat ishin pasojat që krijoi rënia e Tivarit dhe Ulqinit në organizimin e faktorit politik shqiptar dhe masat diplomatike që ndërmorën Fuqitë e Mëdha me këtë rast?*

DAUTI: Konferenca e Shën Stefanit e krijoi një Bullgari të madhe që ishte dorë e zgjatur e Rusisë. Territori i kësaj Bullgarie depërtoi thellë në tokat e Shqipërisë dhe Kosovës së sotme. Me fjalë të tjera, formimi i një Bullgarie të këtille ishte kundër

idesë së ekzistimit të shtetit të ardhshëm shqiptar. Shën Stefani ishte një tendencë e zgjerimit pan sllav të sponsorizuar nga Rusia. Kjo ishte diçka që britanikët, por edhe fuqitë e tjera evropiane, nuk ishin në gjendje ta pranonin. Prandaj, u organizua Kongresi i Berlinit dhe deri në këtë pikë qëndrimi britanik dhe ai i disa fuqive të tjera ishte i përbashkët me atë të shqiptarëve. Rënia e Tivarit, Ulqinit dhe territoreve të tjera të banuara me shqiptarë, i radikalizoi shqiptarët. Ishte momenti kur udhëheqësit shqiptarë filluan të kërkonin dalje nga Perandoria Otomane, e cila u pa se më nuk ishte në gjendje të ofronte mbrojtje për territoret që shqiptarët i konsideronin të vetat.

*Çfarë propozimi ekzistonte për ndërrim territorësh, kur bëhet fjalë për Ulqinin?*

DAUTI: Ka pasur disa propozime që i kishte paraqitur Porta për ndërrim me Ulqinin, por dy kanë qenë më të rëndësishme. Propozimi i parë kishte të bënte me një territor të Sanxhakut që gjendej në lindje të kufirit me Malin e Zi. I dyti kishte të bënte me një territor të Hercegovinës. Britanikët i përkrahën që të dy propozimet, por austro-hungarezët ishin kundër. Vjena nuk dëshironte që ta zvogëlonte territorin e saj në Hercegovinë dhe as që e kishte ndërmend që ta ngushtonte rripin e Sanxhakut që e ndante Serbinë nga Mali i Zi. Prandaj, u propozua që territori që do të kalonte në Mal të Zi do të mbetej Ulqini.

*Një prej pjesëve vërtet mbresëlënëse në studimin tuaj është ajo që ka të bëjë me rezistencën e shqiptarëve kundër dorëzimit të Ulqinit të malazezët.*

DAUTI: Nga viti 1978 e deri më 1881 shqiptarët u organizuan si kurrë më parë. Kur ushtria otomane u tërhoq nga territoret të cilat duhej t'i jepeshin Malit të Zi, forcat shqiptare nxituan dhe i zunë pozicionet e braktisura otomane para se të vinin malazezët. Më në fund, konsulli Green u detyrua ta pranonte fuqinë organizative të Lidhjes së Prizrenit që e bënte dega e saj në Shkodër. Mijëra shqiptarë të armatosur ia mësyn kufirit. Liqeni i Shkodrës ishte mbushur me anije të cilat transportonin luftëtarë për në front. Furrat në Shkodër nxirrnin çdo ditë nga 8000 okë bukë që dërgoheshin në kufi. Një vijë e gjatë e grave dhe fëmijëve ishte formuar për bartjen e ushqimeve dhe municioneve. Në kufi erdhën edhe forca nga Mirdita e cila gjë i befasoi dhe i frikësoi konsujt në Shkodër. Orkestra e qytetit të Shkodrës, luftëtarët që shkonin në kufi, i përcillte me ekzekutime muzikore. Bizneset në Shkodër dhe

rrethinë filluan të funksiononin në dobi të organizimit të luftës. Konsujt filluan të shkruanin raporte në të cilat shprehnin habi për organizimin e shqiptarëve dhe përcaktimin e tyre për t'i mbrojtur tokat e tyre.

*Në këtë kohë kishte shumë ngjarje edhe në Vilajetin e Janinës dhe të Manastirit, por kishte edhe angazhime greke për shkak të trazirave në jug të Shqipërisë për ta fuqizuar pozitën e tyre, apo jo?!*

**DAUTI:** Qeveria greke nuk pushoi së penguari çështjen shqiptare në vilajetin e Janinës dhe Manastirit. Këtë pengesë ajo e bënte duke e mobilizuar ushtrinë për kërcënim të kufijve, duke angazhuar diplomacinë e vet në botë, kurse në terren e angazhonte kishën ortodokse. Me këtë Athina mëtonte ta bindte botën se të gjithë të krishterët ortodoksë janë grekë. Qeveria greke mendohej ta destabilizonte edhe pjesën e Shqipërisë ku nuk kishte ortodoksë. Athina paguante mjaft agjentë shqiptarë katolikë dhe myslimanë të cilët, haptas apo fshehurazi, i shërbenin kauzës greke në dëm të asaj shqiptare.

*Në punimet dhe studimet tuaja keni bërë me dije për kundërshtimin e britanikëve ndaj qëndrimit francez që paraqejtë si mbrojtës për interesat greke në raport me Shqipërinë. Cili ishte qëndrimi britanik dhe i fuqive të tjera përkitazi me çështjen shqiptare dhe me kufirin e Greqisë në kohën për të cilën po flasim dhe cili ishte Protokollit XIII i Traktatit të Berlinit dhe përse insistonin britanikët për zbatimin e tij?*

**DAUTI:** Protokollit XIII i Traktatit të Berlinit parashihte që qeveria otomane dhe ajo greke duhej të merreshin vesh në baza dypalëshe për kufirin e ri të shtetit grek. Nëse këto dy palë nuk merreshin vesh, atëherë duhej kërkuar ndihmë nga Fuqitë e Mëdha. Deri në fillim të vitit 1880 nuk pati marrëveshje. Grekët kërkonin një territor të gjerë që zgjerohej në drejtim të veriut apo territoreve shqiptare. Otomanët e refuzonin këtë zgjerim dhe ofronin më pak territor. Kërkesa greke përkrahej tërësisht nga Franca. Grekët kërkuan edhe përkrahje nga britanikët. Për këtë arsye, në fillim të janarit të atij viti, ambasadori grek në Londër u takua me sekretarin e jashtëm britanik. Por, britanikët nuk e përkrahën propozimin grek për shkak se mendonin që ishte i pabazë dhe i paarsyeshëm. Ambasadori grek kishte folur me hidhërim para sekretarit britanik. Sekretari britanik i kishte thënë diplomatit grek se vonesa rreth caktimit të kufirit po bëhej për shkak se pretendimet e Athinës po e vështirësonin situatën. Madje, sekretari i jashtëm ia bëri me dije edhe kryeministrit francez, Waddingtonit, që të hiqte dorë nga përkrahja e kërkesës greke për shkak se ekzistonte mundësia që ky qën-

drim, si reagim, do të ndikonte në rritjen e aspiratave të shqiptarëve për pavarësi. Porta dhe Fuqitë e Mëdha nuk ishin të gatshëm që të merreshin me çështjen e pavarësisë së shqiptarëve. Prandaj, Konferenca e Berlinit e lejoi një zgjerim të 'moderuar' të Greqisë dhe Franca, për shkak të Britanisë, hoqi dorë nga mbrojtja e kërkesës së paarsyeshme greke.

*Cilat ishin angazhimet britanike dhe ato të fuqive të tjera për ta bindur Portën dhe shqiptarët për zbatim të vendimeve të Konferencës së Berlinit?*

**DAUTI:** Gladstone, sapo erdhi në pushtet, i dërgoi sinjale Portës se nuk do ta toleronte zhargitjen e procesit të dorëzimit të territoreve, sidomos pas Konferencës së Berlinit. Për këtë çështje, nën ndikimin e tij, ranë të gjitha Fuqitë e Mëdha dhe e mobilizuan një flotë të madhe detare të cilën e përqendruan në Dubrovnik. Nga aty, i kërcënoheshin sulltanit dhe Lidhjes së Prizrenit që t'i dorëzonin territoret, gjegjësisht Ulqinin me rrethinë. Kërcënimin me paraqitje të flotës në brigjet e Ulqinit nuk dha rezultat. Sulltani arsyeohej se konflikti i forcave të tij me ato të Lidhjes prodhonte rrezik të shkatërrimit të perandorisë. Shqiptarët ishin betuar se do ta mbronin Ulqinin me çdo kusht. Gladstone shkoi edhe një hap më tej. Ai iu kërcënua sulltanit se nëse nuk i dorëzonte territoret, flota e tij do të lundronte më tej dhe do ta okuponte portin e Izmirit dhe të hyrat e doganës otomane do t'i shfrytëzonte për pagesë të vonësës së dorëzimit të territoreve. Ky ishte një cenim i rëndë i sovranitetit otoman që e poshtëronte sulltanin. Fuqitë e tjera nuk e përkrahën këtë propozim të Gladstoneit. Gladstone i dërgoi porosi sulltanit se këtë gjë do ta bënte vetëm me flotën britanike. Në fakt, ky ishte një 'blof', por që dukej realitet. Një konflikt mes britanikëve dhe otomanëve krijonte rrezik të madh për Fuqitë e Mëdha. Madje, me këtë nuk u pajtua as Bizmarku, i cili shkroi se 'Gladstone po sillet si një profesor i çmendur'. Sidoqoftë, sulltani besoi në kërcënimin e Gladstoneit dhe lëshoi pe. Kjo nënkuptonte se Porta tashti duhej të dërgonte forca të mëdha për t'i detyruar shqiptarët që t'i lëshonin tokat e tyre, përfshirë Ulqinin. Kjo gjë ndodhi dhe, pas disa përlëshjeve ushtarake, forcat otomane e okupuan Ulqinin të cilin ua dorëzuan malazezëve sipas marrëveshjes. Pastaj, sulltani e urdhëroi ushtrinë që të merrej me nënshkrimin e forcave të Lidhjes dhe për këtë e kishte përkrahjen e Fuqive të Mëdha. Deri më 1881 u shpërbë Lidhja e Prizrenit dhe mori fund organizimi politik, ushtarak dhe ekonomik shqiptar në katër vilajetet. Por, dëshira e shqiptarëve për autonomi, eventualisht pavarësi, nuk u shua.

*(Marrë nga numri i shtatë i revistës "Akademia". Fund)*

# Politika e brendshme dhe e jashtme e Skënderbeut

-Me rastin e 552-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut

## NEXHAT KRASNIQI

Pas marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Raguzës, një qytet i dalluar tregtar, Skënderbeu kishte edhe mbështetje ekonomiko-financiare nga Ragusa. Sipas një dokumenti të datës 17.V.1447, personaliteti i Skënderbeut nga Zyra e Republikës së Raguzës është quajtur "Gjergj Kastrioti, Zot i Arbërisë" (doino Giorgio Castriotis de Albania). Por kishte edhe çaste jo të mira, sidomos në nëntorin e vitit 1466 kur u nis për Itali, e në prill 1467 kur u kthye nga Italia, zemërimi i osmanëve e rrezikonte edhe vetë Republikën e Raguzës. Vëllezërit Gjin e Pal Gazuli ishin qytetarë raguzianë me gjak shqiptar, të cilët përcollën me interesim të veçantë ngjarjet në Shqipëri dhe ishin në lidhje të ngushta me Skënderbeun, duke kryer edhe shërbime konsullare në favor të shtetit shqiptar, si në Raguzë, Venedik etj.

Rapporte diplomatike kishin edhe me vendet italiane, si me Venedikun, Papatin, Napolin etj. Venediku kishte zotërimet e territoreve shqiptare, prandaj ky element e rivaliteti për dominim në Ballkan e Mesdhe në përgjithësi, e bëri që mos të ketë raporte të mira diplomatike me shtetin shqiptar të udhëhequr nga Skënderbeu. Ishte konflikti me Venedikun një nga arsyet kur Skënderbeu nuk mundi t'i shkonte në ndihmë Janush Huniadit më 1448. Më 1451 Skënderbeu kërkoi nga Republika e Venedikut të vendoste në Krujë një garnizon ushtarak për ta përfshirë atë në luftën antiosmane. Kjo kërkesë në atë kohë ishte në kundërshtim me politikën venedicane, prandaj Senati e hodhi poshtë atë. Megjithatë, fuqizimi i Perandorisë Osmane e detyroi Venedikun të kishte raporte të mira diplomatike me Skënderbeun. Sidomos ishin vitet '60 kur osmanët preken zotërimet tregtare të Venedikut në Pelepones e më gjerë. Pra, kjo ishte arsyeja pse Republika e Venedikut kishte përafërime diplomatike me Skënderbeun. Kjo tregon edhe më faktin që R. e Venedikut nderon me dhënien e titullit "fisnik venecian", më 1463, prej dukës Kristofor More, djalit të Skënderbeut, Gjonit, i cili ende ishte fëmijë.

Interesi i përbashkët mes Skënderbeut e Papatit për ta ndalë vrullin e Perandorisë Osmane në Ballkan dhe më gjerë pati insistime bashkëpunimi, që të pengohet dhe, njëkohësisht, në aspektin politik-ushtarak fuqia e Perandorisë Osmane të mundet. Papati e vlerësonte shumë luftën antiosmane të shqiptarëve, e mbështeti moralisht, e propagandoi gjerësisht atë, i dha Skënderbeut titullin "Mbrojtës i krishterimit" dhe Kapiten i Përgjithshëm i Selisë së Shenjtë. Nuk mungonte mbështetja financiare nga Papati, sidomos në vitet



'60, por ajo ishte larg kërkesave që duheshin për t'i dalë përballë një fuqie të kohës siç ishte Perandoria Osmane. Megjithatë, Papati i dha rol të veçantë Skënderbeut, sidomos në një organizim të një lufte të përbashkët në nivel evropian, për t'ia ndalë hovin Perandorisë Osmane dhe bërë shkatërrimin e saj. Megjithatë nuk u arrit... Marrëdhënie diplomatike Skënderbeu kishte edhe me Mbretërinë e Napolit, sidomos me Alfonsin V. Interesat e përbashkëta të Skënderbeut e Alfonsit V bënë që të dytë ta shfrytëzonin autoritetin e njëri-tjetrit për ta ndalë hegemoninë osmane. Mbretëria e Napolit kishte bërë në Ballkan një sërë marrëveshesh me princat shqiptarë dhe të tjerë, por veçohet marrëveshja e Skënderbeut dhe Alfonsit në Gaeto të Italisë, afër Napolit, më 26. II. 1451. Si diplomat të Skënderbeut në këtë ngjarje u dalluan ambasadorët, ipeshkvi i Krujës, Shtjefani dhe Nikollë Berguci. Mbreti Alfonsi V ishte hartues i tekstit të Traktatit, një dokument me vlera të veçanta diplomatike. Traktati i Gaetos është përfunduar në emër të Skënderbeut si sundimtar i Principatës së Kastriotëve dhe të kryezotërinjve të tjerë shqiptarë, farefisit ose vasalëve të tij si, p. sh., Gjergj Arianiti, Gjin Muzaka, Gjergj Stresh Balsha, Pjetër Spani, Palë Dukagjini, Muzak Topia, Simon Zenevisa etj. Duhet veçuar që pati edhe marrëveshje të veçanta me princat e lartpërmendur dhe mbretin e Napolit, Alfonsi V, si p. sh., ai me Gjergj Arianitin disa muaj më vonë, përmenden tokat e përbashkëta që do të çliroheshin me forcën e përbashkët.

Në marrëveshjen mes Skënderbeut dhe Alfonsit V për tokat që do të çliroheshin me forcë të përbashkët, thuhej se ato do t'i zotëronte mbreti Alfonsi V bashkë me Skënderbeun dhe kryezotërinjët e tjerë shqiptarë.

Traktati i Gaetos ishte një aleancë mes Alfonsit V e Skënderbeut, për ta luftuar me forcë të përbashkët pushtimin osman të Shqipërisë, por në pikëpamje juridike ai ishte një traktat vasaliteti mes kushteve të caktuara. Megjithatë, Skënderbeu mbeti plotësisht i pavarur me politikën e brendshme dhe të jashtme...

Pas disfatës së Beratit, ku koalicioni i përbashkët pësoi shumë nga ushtria osmane, Alfonsi V praktikisht u

tërhuq nga Shqipëria dhe me vdekjen e tij më 1458 Traktati pushoi së ekzistuari.

Froni në Napoli u trashëguua nga djali i Alfonsit V, Ferdinandi (Ferrante). Për të qenë i plotfuqishëm Traktati, ai duhet të përsëritet me të njëjtat kushte, e që nuk u arrit. Ferdinandi u gjend në një situatë tejet të vështirë nga kundërshtarët e tij dhe Skënderbeu, si shenjë respekti ndaj Mbretërisë së Napolit, në shtator 1460 dërgoi grupin e parë të luftëtarëve të udhëhequr nga nipi Koiko Stres Balsha për ta ndihmuar Ferdinandin, djalin e mikut të vjetër të Skënderbeut, Alfonsit V, njëkohësisht t'i vazhdonte raportet diplomatike me Napolin. Princi i Tarentit, Xhovan Antonio de Orsini, i shkroi me ironi Skënderbeut të tërhiqej. Edhe Skënderbeu ia ktheu në të njëjtën mënyrë, duke shkruar: "Në qoftë se kronikat toka nuk gënjejnë, ne quhemi epirotë. Duhet ta dini se në kohë të tjera paraardhësit tanë kaluan në vendin që mbani sot dhe patën bërë luftëra të mëdha me romakët. Dhe, nga sa dimë, në të shumtën e rasteve u ndanë me nder sesa me turp". Në fund të gushtit 1461 Skënderbeu zbarkoi vetë në Itali me dy-tre mijë luftëtarë. I mundi forcat kundërshtare dhe vetë Xhovan Antonio de Orsini hyri në bisedime me Skënderbeun, i cili kërkoi që ky të ndërmjetësonte të lidhte paqe me mbretin Ferdinand. Kjo i dha një ringjallje të marrëdhënieve diplomatike mes Mbretërisë së Napolit dhe Skënderbeut -prijësit të shtetit shqiptar. Në shenjë mirënjohje për këtë ndihmë, mbreti Ferdinand i dhuroi Skënderbeut feudet e Monte Sant Angjelos e të San Xhovani Rotondos, si dhe një pension vjetor prej 1 200 dukatësh.

Skënderbeu krijoi raporte të mira edhe me shtetet e tjera italiane, si me Dukatin e Milanos, Mantovën, Sienën etj., madje edhe me vendet e largëta evropiane si me Dukatin e Burgonjës (Francë), por ato nuk ishin intensive si me Napolin, Venedikun e Papatin.

Rapporte diplomatike Skënderbeu krijoi edhe me vendet e Azisë së Vogël si, p. sh., me Ibrahimin e Karamanisë. Ibrahim i një projekt për luftë të përbashkët kundër Perandorisë Osmane, një vend qendror u dha aksioneve të shqiptarëve.

Shqiptarët si popull i lashtë në Gadishullin Ilirik (Ballkanik), pavarësisht prej vështirësive të kohërave të ndryshme, mbijetuan dhe në kohë të ndryshme ishin faktor i Gadishullit Ilirik, sidomos në periudhën e Skënderbeut. Periudha e lavdishme e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut i tregoi edhe vijat e diplomacisë shqiptare se ka duhet orientuar.

Lavdi jetës dhe veprës së heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu!

*(Portretin e Skënderbeut, piktori Agim Sulaj)*

E rrallë

## Në një hotel në Sri Lanka mysafirët i pret një elefant

Ajo çfarë turistët nuk e presin kur akomodohen në një hotel për të pushuar, është një elefant duke ecur nëpër korridor. Megjithatë, në hotelin "Jetwing Yala" në Sri Lanka kjo është diçka e zakonshme. Një video e hedhur në rrjetet sociale është bërë virale në të gjithë botën, ku duket një elefant



që qëndron në ambientet e hotelit. Ndërsa shumë persona e shpërndanë videon në pak çaste, stafi i hotelit ka deklaruar se elefanti është shumë 'besnik' ndaj stafit që prej vitit 2013.

FOTO E DITES



Një pamje ajrore tregon peizazhin e Buso Busos në Filipine që është mbuluar me hiri pas vullkanit të shpërthimit Taal. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Zogu-robot me pupla të vërteta fluturon me sukses

Shkencëtarët kanë krijuar një robot të quajtur PigeonBot, i cili është i përbërë nga 40 pendë dhe disa gjëra të tjera. Ndërsa avionët janë duke manovruar duke ndryshuar pozicionin e elementeve të krahut, zogjtë mund të ndryshojnë tërë formën e krahut, në varësi të mënyrës se si fluturojnë. Kjo është se si rritet efikasiteti i krahëve,



kështu që shkencëtarët donin t'i integronin këta elementë në makinat fluturuese. PigeonBot përfundimisht u ngrit dhe u ul me sukses, një hap i madh në evolucionin e avionëve.

## BARSOLETA E DITËS



Një gjakovar me të fejuarën po kalonin përpara një qebaptoreje. Ajo, pasi ndien erën e qebapëve të pjekur, i thotë:  
- Sa erë e mirë që vjen!  
Gjakovari i thotë:  
- Eja kalojmë edhe një herë kah lokali.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



#### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



#### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min  
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.  
**Regjia:** J.J. Abrams




#### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p><b>DASHI</b> Mërkuri tek Ujori nuk duhet të nënvlerësohet. Ai mbetet në kundërshtim deri në fillim të shkurtit.</p>	 <p><b>DEMI</b> Yjet shkëlqejnë në shenjën tuaj, jeta emocionale rritet. Nëse jeni duke pritur për një përgjigje themelore për punën tuaj, përshpejtoni!</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Pas Marsit, Hëna zbret në shenjën e kundërt të Shigjetarit. Në frontin e punës është më mirë të bëni kujdes për t'i shmangur shpërqendrimet, gabimet dhe gafat.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Dashuria, me Venusin te Peshqit, e vendosur nga ana juaj, do të jetë në plan të parë, por me një kontrast për t'u zgjidhur. Bëni një lëvizje fizike.</p>	 <p><b>LUANI</b> Do të keni një buzëqeshje të ndritshme. Ju me siguri keni një energji të madhe nga juaj për të shpenzuar.</p>	 <p><b>VIrgjërësja</b> Hëna ditën e sotme do t'ju bëjë të përballeni me negativitet. Tranziti do ta prekë kryesisht sektorin e familjes dhe sferën private.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Ditë e këndshme dhe e zënë. Betejat shoqërore, arritjet, sukseset personale dhe profesionale do ta rrisin shumë nivelin e vetëbesimit!</p>	 <p><b>AKREPI</b> Një ditë kritike për financa, veçanërisht në kohë e fundit jeni çmendur ose nxitur nga entuziazmi, keni bërë blerje të egra, të pamatur.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Mos i shtyni çështjet ligjore ose burokratike, por punoni për t'i zgjidhur ato në mënyrën më të mirë.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Do të përjetoni momente intimiteti dhe romantizmi të këndshëm, aq sa edhe ju të jeni në gjendje t'i kuptoni nuancat dhe dëshirat e pashprehura.</p>	 <p><b>UJORI</b> Disponueshmëria dhe energjia janë në dispozicionin tuaj për t'ju çliruar nga një situatë e ndenjur.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Hëna nuk është në anën tuaj sot, kështu që ju do të jeni shumë i nervozuar. Numëroni në dhjetë para se të flisni.</p>

## Rihanna i rikthehet ish të dashurit



**C**do gjë që Rihanna bën pa dyshim se është pjesë e shtypit rozë, së fundmi është përfolur për ndarjen e saj me miliarderin arab Hassan Jameel pas tre vjetësh lidhje. Ndarja e tyre ishte e papritur pasi çifti vetëm pak kohë më parë ishte njohur me familjet dhe të gjithë po prisnin që ta merrnin hapin tjetër drejt martesës.


Nuk ka vonuar shumë dhe Rihanna po përfillet për një lidhje të re. Mediat e huaja shkruajnë se këngëtarja e ka kaluar mbrëmjen e së dielës në një klub nate me reperin ASAP Rocky. Vite më parë Rihanna dhe ASAP Rocky kanë qenë në një lidhje të cilën e bënë edhe publike me gjestet e dashurisë që bënë gjatë një koncerti.

## Aktorja e famshme ndryshon pamjen



**A**jo është një nga aktoret më të njohura. Hilary Duff e ka nisur vitin 2020 me një ndryshim në

pamje. 32-vjeçarja ka vënë shtesa flokësh, ndërsa këtë ndryshim e ka paraqitur në rrjetin social "Instagram".



## Brad Pitti dhe Jennifer Anistoni shfaqen bashkë

**T**ë dielën në mbrëmje u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimeve "Screen Actors Guild". Dy nga aktorët e njohur që u nderuan me këto çmime ishin aktorja Jennifer

Aniston dhe aktori Brad Pitt. Çifti i dikurshëm u takuan në prapaskenë, pasi i kishin fituar çmimet e tyre, ndërsa e gjithë vëmendja e fotoreporterëve ishte te hollësitë e këtij takimi.

## Amy Schumer dëshiron të ketë edhe një vajzë

**A**ktorja e njohur Amy Schumer do të dëshironte ta bënte djalin e saj edhe me një motër. Ajo në një intervistë në emisionin e Oprah Winfrey ka thënë se është një përvojë shumë e

mirë të kesh fëmijë. "Kjo më ka ndërruar jetën. Unë e dua shumë birin tim. Unë e imagjinoj çdoherë veten me familjen time në plazh dhe fëmijët e mi teksa luajnë", ka thënë Schumer.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# FBK-ja sërish ia beson Rahovecit organizmin e Final 8

KB Rahoveci për të dytin vit me radhë e merr përsipër organizmin e Final 8 të Kupës së Kosovës në basketboll. Elvira Dushku nga FBK-ja dhe Alban Rama nga KB Rahoveci kanë shprehur besimin se garat e Kupës do të jenë madhështore sikurse vitin e kaluar

PRISHTINË, 20 JANAR - Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe KB Rahoveci të hënën kanë nënshkruar marrëveshjen për organizimin e Final 8 të Kupës së Kosovës në Basketboll nga skuadra e Rahovecit. Marrëveshja është nënshkruar nga sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku dhe ushtruesi i detyrës së kryetarit të KB Rahovecit, Alban Rama. Dushku ka falënderuar mediat për interesimin e madh të tyre, derisa u shpreh se në bashkëpunim me klubin e Rahovecit do të përpiqen ta organizojnë në mënyrën më të mirë të mundshme Final 8 të Kupës. "Pres spektakël për Kupë, ashtu siç ishte vitin e kaluar me shumë tifozë nga klubet pjesëmarrëse të Kupës", ka thënë Dushku. Ndërsa Alban Rama theksoi se si



organizator do të bëjnë çmos që gjithçka të shkojë sipas planit dhe organizimi ka filluar kohë më parë. "Pres që atmosfera të jetë e jashtëzakonshme për këtë Final 8 të Kupës, ashtu siç ka qenë deri më tani në Rahovec. Besoj se gjithçka do të shkojë mirë", ka thënë Rama, i cili ka ftuar adhuruesit e basketbollit t'i përkrahin skuadrat e tyre të zemrës. Në këtë konferencë është bërë edhe prezantimi i logos së Final 8 nga sekretari i KB Rahovecit, Besart Zeka. Final 8 i Kupës së

Kosovës do të organizohet nga 11 deri më 15 shkurt në Palestrën "Mizair Isma" në Rahovec. Kjo do të jetë hera e dytë radhazi që klubi i Rahovecit organizon pjesën përfundimtare të Kupës. Edhe vitin e kaluar ishte organizuar në Rahovec, ku atmosfera ka qenë e jashtëzakonshme. Gjithashtu, në këtë konferencë është publikuar edhe orari i Final 8. Të gjitha ndeshjet do të transmetohen ekskluzivisht në "Art Motion", që është partner medial i FBK-së.

## SHKURT

### Celina, afër rikthimit në Premierë Ligë

Bersant Celina është duke zhvilluar një sezon pozitiv me skuadrën e Swansesë në Championship. Mesfushori i Kosovës mund të rikthehet në Premierë Ligë pasi disa klube kanë shfaqur interesim për të. Së fundi imediat ishullore raportojnë se për futbollistin me origjinë nga Prizreni klubi i Brightonit ka gati ofertë për të. "The Sun" shkruan se trajneri Graham Potter pëlqen cilësitë e Celinës dhe klubi i Brightonit ka gati 10 milionë funte për kartonin e shqiptarit. Celina ka luajtur më parë me ekipin e Manchester Cityt dhe është i gatshëm për të hedhur një hap të madh në karrierën e tij.

### Gashi largohet nga Ferizaj

Sulmuesi Dren Gashi nuk do ta djersitë fanellën e skuadrës së Ferizajt në sezonin pranveror, pasi ai e ka zyrtarizuar largimin nga ky klub. "Nuk jam më pjesë e FC Ferizajt. Faleminderit të gjithëve për këto dy vjet të mrekullueshme!", thuhet në njoftimin e Ferizajt.

### Çeferin do të jetë i pranishëm në ndeshjen Maqedoni - Kosovë

Sekretari i Përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu, ka thënë se presidenti i shtëpisë më të madhe në futbollin evropian UEFA, Aleksander Čeferin, do të jetë i pranishëm në ndeshjen gjysmëfinale të Ligës së Kombeve, Maqedoni e Veriut - Kosovë. Kjo ndeshje do të luhet më 26 mars në Shkup. "Presidenti Aleksander Čeferin ka konfirmuar se do të jetë në këtë ndeshje. Kjo sfidë konsiderohet e rrezikshmërisë së lartë, por besoj dhe shpresoj se do të kalojë pa probleme", ka thënë Salihu. Fituesi i ndeshjes Maqedoni e Veriut - Kosovë përballë me fituesin e gjysmëfinalës tjetër Bjellorusi - Gjeorgji ku fituesi do ta sigurojë një biletë për Kampionatin Evropian "Euro 2020".

### Napoli zyrtarizon transferimin e Rrahmanit

Skuadra e Napolit e ka zyrtarizuar transferimin e mbrojtësit të Përfaqësueses së Kosovës, Amir Rrahmani. Në faqen zyrtare të klubit italian njoftohet se Rrahmani do të qëndrojë në formë huazimi te Hellas Verona deri në qershor të këtij viti. Kapiteni i Kosovës ditë më parë i kaloi me sukses testet mjekësore dhe pjesë e Napolit do të bëhet që nga qershor i këtij viti. Ai me Napolin ka firmosur kontratë deri në qershor të vitit 2024. Rrahmani karrierë më herët ka bërë në Kosovë te Kosova e Prishtinës, Ramiz Sadiku, Drenica, kurse ka luajtur edhe për Partizanin e Tiranës, RNK Splitin, Lokomotivën dhe Dinamon e Zagrebit.

#### Orari

##### Më 11 shkurt takohen:

14:00 Vëllaznimi - Istogu (Kupa e Ligës së Parë)  
16:30 Grupi D Peja - Ponte Prizreni/Prishtina e Re  
19:00 Grupi A Rahoveci - Trepça/Vushtrria

##### Më 12 shkurt takohen:

14:00 AS Prishtina - Drita (Kupa e Ligës së Parë)  
16:30 Grupi B Bashkimi - Feronikeli/Drita  
19:00 Grupi C Sigal Prishtina - GoldenEagle Ylli/Megasport

##### Më 13 shkurt takohen:

14:00 Finalja e Ligës së Parë  
16:30 Gjysmëfinalja e Parë  
19:00 Gjysmëfinalja e Dytë

##### Më 15 shkurt takohen:

17:30 Finalja e Femrave  
20:30 Finalja e Kupës së Kosovës

## Ademi dhe Sejdini diskutojnë për ndeshjen Maqedoni - Kosovë

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, ndihmëstrajneri i përfaqësueses, Muharrem Sahiti dhe menaxheri i ekipit përfaqësues, Bajram Shala, zhvilluan një takim pune me presidentin e

Federatës së Futbollit të Maqedonisë së Veriut, Muhamed Sejdini, që shoqërohej nga bashkëpunëtorët. "Në këtë takim presidenti Ademi dhe homologu i tij Sejdini diskutuan për t'i koordinuar veprimet për organizim sa më të mirë të ndeshjes gjysmëfi-

nale të 'play-off'-it për Kampionatin Evropian që zhvillohet më 26 mars. Ademi kërkoi nga homologu i tij që ta bëjë maksimumin për ta rritur numrin e biletave që do të jenë në dispozicion për shikuesit nga Kosova", thuhet në njoftimin e FFK-së.





## Fitojnë San Antonio dhe Indiana

SAN ANTONIO, 20 JANAR - Dy ndeshje janë zhvilluar në NBA. Skuadra e San Antonios e mposhti me rezultat 107-102 Miamin, një përballje interesante mes dy ekipesh legjendarë në NBA, ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë

tjetri. Diferencën e bënë lojtarët e stolit të Spursit, që realizuan 48 pikë. Më të mirët në fushë ishin Aldridge me 21 pikë dhe DeRozan me 20, ndërsa për Miamin u dallua Adebayo me 21 pikë e 16 rebounde, por që mbetën për statistikë.

Surprizë humbja e Denverit në fushën e tij. Skuadra e Nuggetsit u mund me rezultat 115-107 nga Indiana, humbje që prish disi planet e Denverit për kreun e renditjes në Perëndim. Edhe pse Denveri e udhëhoqi ndeshjen në shu-

micën e kohës, zhgënjeu pikërisht në çastet e fundit. Jokiçi realizoi 30 pikë e 10 rebounde, por që nuk mjaftuan për ta evituar humbjen, ndërsa për Indianan u dallua Sabonis me një "triple double" (22 pikë, 15 rebounde e 10 asistime).



# KOK-u i dërgon gjashtë propozime për ftesa Olimpikë 'Tokio 2020'

PRISHTINË, 20 JANAR - Me kërkesë të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Komiteti Olimpik i Kosovës ka dërguar listën me gjashtë propozime për ftesa Olimpikë "Tokio 2020". Të përzgjedhurit janë bërë në bazë të renditjes olimpikë deri më datë 1 tetor 2019, derisa përparësi është dashur t'u jepet bursistëve olimpikë. Komisioni trepalësh i Lojërave Olimpikë në përbërje: Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Asociacioni i Komiteteve Olimpikë Kombëtare (ANOC) dhe Asociacioni i Federatës Ndërkombëtare të Sporteve Olimpikë Verore (ASOIF) do të vendosin për të propozuarit. Krahas kësaj liste, Kosova pritet të ketë ftesa edhe për dy sportet si



noti dhe atletika, ndërsa sportet që fitojnë të paktën një normë olimpikë nuk mund të përfitojnë ftesë. Listës së të propozuarve iu prijnë boksi dhe karateja me nga dy sportistë. Nga boksi të propozuar janë Donjeta Sadiku, e cila vitin e kaluar u bë kampione e Ballkanit në kategorinë -64 kg, si dhe Patriot Behrami, që zuri vendin e pestë në Lojërat Evropiane Minsk 2019. Nga

karateja janë propozuar Herolind Nishevcu, medalist i bronzitë botëror në vitin 2016, si dhe Fortesa Orana. Dy të propozuarit e tjerë janë Drilon Ibrahimimi nga shenjëtaria sportive dhe Fatih Karabaxhaku nga pingpongu. Sadiku, Nishevcu, Orana dhe Ibrahimimi janë Bursistë Olimpikë Tokio 2020, ndërsa Behrami e Karabaxhaku janë Shpresa Olimpikë 2020.

### LISTA E TË PROPOZUARVE

- |                      |                       |
|----------------------|-----------------------|
| 1. Donjeta Sadiku    | (boks)                |
| 2. Herolind Nishevcu | (karate)              |
| 3. Patriot Behrami   | (boks)                |
| 4. Fortesa Orana     | (karate)              |
| 5. Drilon Ibrahimimi | (shenjëtari sportive) |
| 6. Fatih Karabaxhak  | (pingpong)            |

# Liverpoli i frikshëm, mund të thyejë 10 rekorde

LIVERPOOL, 20 JANAR - Liverpooli këtë sezon është vërtet i frikshëm. Skuadra e "The Reds" mposhti të dielën Manchester Unitedin në atë që konsiderohet si "Clasice" e Premierë Ligës. Tashmë diferenca me Manchester Cityn që barazoi me Crystal Palacen shkon në 16 pikë e për më tepër "The Reds" kanë edhe



një ndeshje për të luajtur. Duke parë këtë sezon në kufijtë e përfektes për skuadrën e Jurgen Kloppit është logjike të mendohet se Liverpooli mund të thyejë 10 rekorde historike të Premierë Ligës në këtë sezon. Njërin në fakt e kanë thyer; atë të startit më të mirë të sezonit me 21 fitore në 22 ndeshje duke kaluar atë të Manchester City në sezonin

2017/18. Rekordi i dytë në shënjestrën e skuadrës që drejtohet nga Kloppi është ajo e numrit më të lartë të fitoreve në fushën e tyre. Me suksesin ndaj "Djajve të Kuq" në "Anfield", Liverpooli është vetëm një fitore larg rekordit të Cityt në 2011/2012 me 20 fitore radhazi në shtëpi. Southampton dhe West Hami janë skuadrat e radhës që do ta vizitojnë fortesën

"Anfield" ku Liverpooli nuk nje humbje që nga viti 2017. Pak më larg qëndron rekordi i numrit më të lartë të fitoreve radhazi në kampionat me Liverpoolin që i duhen edhe 5 të tilla për ta barazuar numrin e 18 fitoreve radhazi të Manchester Cityt në 2017/18. Nëse do të vazhdojë me këtë ritëm, Liverpooli pritet ta vendosë rekordin e ri në ndeshjen me Watfordin më 29 shkurt. Po kështu në shënjestrën e Liverpoolit është edhe numri i fitoreve radhazi në shtëpi. Deri tani Liverpool ka 12 të tilla dhe është vetëm 7 fitore larg rekordit të vendosur nga Chelsea, Manchester Unitedi dhe Manchester City.

### SHKURT

#### Mercedesi 'blindon' Hamiltonin

Pavarësisht zërave që qarkullojnë kohët e fundit në lidhje me të ardhmen e Lewis Hamiltonit, në lidhje me kalimin e tij te Ferrari, piloti britanik është gati ta rinovojë kontratën me Mercedesin. Kontrata aktuale skadon në fund të këtij sezoni, por makina gjermane synon t'ia rinovojë atë deri në vitin 2022. Sipas "Gazzetta Dello Sport", Mercedesi është gati t'ia ofrojë shumën marramendëse prej 90 milionë eurosh për dy sezone (45 milionë për sezon). Një ofertë e jashtëzakonshme, por e domosdoshme për të mbajtur në skuadër 6 herë kampionin e botës në Formula 1. Mësohet se kjo ofertë ka mbërritur në tavolinën e Hamiltonit, që pritet të respektojë për të ardhmen. Gjithçka do të varet nga njëvendëshja që do t'i ofrojë Mercedesit, me ndryshimet në rregulloren e garës që do të aplikohen nga viti 2021.

#### PSG-ja e konsideron të ulët ofertën e Atletico për Cavanin

Drejtori sportiv i PSG-së, Leonardo, ka folur hapur rreth situatës së Edinson Cavanit, duke e konfirmuar kërkesën e tij për largimin drejt Atletico Madridit. Leonardo e konfirmoi që klubi ka marrë një ofertë por, sipas tij, është e ulët. "L'Equipe" ka raportuar se bëhet fjalë për 10 milionë euro, por që është refuzuar. "Kemi shpresuar që Cavani do të vijonte me ne, por na ka kërkuar të largohet. Po e studiojmë si situatë. Kemi marrë një ofertë nga Atletico Madridi, por nuk është në nivelin e lojtarit. Nuk i kemi vendosur kurrë një çmim Cavanit, e respektojmë dëshirën e tij. Duhet të jemi të qartë: sulmuesi dëshiron të largohet", ka thënë Leonardo.

#### Portieri i Unitedit pëson aksident të frikshëm

Një ngjarje e frikshme ka tronditur skuadrën e Manchester Unitedit mëngjesin e së hënës. Portieri i "djajve të kuq", Sergio Romero, ka pësuar një aksident me makinën e tij sportive me vlerë afër kompleksit stërvitor të klubit. Makina ka pësuar dëme serioze, pasi kishte kaluar tejprtej barrierën anësore të rrugës. Klubi i Manchester Unitedit ka konfirmuar se lojtari nuk është lënduar. Argjentinasi ishte në stol edhe në humbjen 2-0 përballë Liverpoolit, në "Anfield". Romero ka 5 sezone që luan me Unitedin duke qenë gjithmonë portieri i dytë i ekipit.

#### Moses, transferimi i dytë i Interit

Victor Moses do të jetë transferimi i dytë i Interit në këtë afat kalimtar, pasi më herët e ka transferuar Ashley Young nga Manchester Unitedi. Mediat italiane kanë raportuar se skuadra klubi "zikaltër" ka arritur marrëveshje me Chelsea për huazimin e futbollistit nigerian deri në fund të sezonit, me të drejtë blerje për 10 milionë euro. 29-vjeçari është shumë i pëlqyer nga trajneri Antonio Conte.

#### Williamsi eliminohet nga 'Australian Open'

Amerikania 15-vjeçare Coco Gauff ka dëshmuar se fitorja ndaj Venus Williamsit në vitin e shkuar nuk ishte befasi, pasi ka mposhtur shtatë herë kampionen, për të arritur në raundin e dytë të "Australian Open". Gauff dëshmoi hyrjen e saj në majë të këtij sporti pasi mposhti "idhullin" e saj në raundin e parë të Wimbledonit në muajin korrik. Sikur atë kohë, ajo mposhti sërish 39-vjeçaren amerikane 7:6, 6:3. Gauff në raundin e radhës do të përballlet me Sorana Cirstean nga Rumania.









Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës

Drejtoria Për Arsimit dhe Edukim

Nr: 11/35

Më: 20.01.2020

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë:20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

**KONKURS**

Për plotësimin e vendeve të punës

Viti shkollor 2019/2020

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" Petro Nini Luarasi" në Llapqevë	Arsimtar/e e mësimi klasorë	Zëvendësimi i lehonisë	1	20

**I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore ( nëse ka)
- Certifikata e lindjes

**II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës mësimdhënës të programit fillor kërkohet kualifikimet: **Fakulteti i Edukimit- programi fillor; Fakulteti i Mësuesisë** ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018, datë 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

**III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.**

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

**SQARIM:** Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

*Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.*

*Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë, orari i intervistave, rezultatet e testit me shkrim, njoftimin për intervistën me gojë dhe vendimin për përzgjedhjen e kandidatit fitues do të publikohen në ueb- faqen e Komunës së Malishevës dhe tabelën e shpalljeve.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

**Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **20.01.2020 deri më datën:03.02.2020.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.

Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës

Drejtoria Për Arsimit dhe Edukim

Nr: 11/36

Më: 20.01.2020

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë:20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

**KONKURS**

Për plotësimin e vendeve të punës

Viti shkollor 2019/2020

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" Gjergj Kastrioti" në Llazicë	Mësimdhënës i lëndës së TIK-ut	Vendi i lirë	1	10

**I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore ( nëse ka)
- Certifikata e lindjes

**II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës mësimdhënës të TIK-ut kërkohet kualifikimet: **Programi /Dega Teknologji-Informatikë; Niveli Master arsimor Fakulteti i Edukimit ( 300 ECTS) Sistemi Katërvjeçar; Bachelor katërvjeçar 240 ECTS);** ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018, datë 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

**III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.**

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

*Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.*

*Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë, orari i intervistave, rezultatet e testit me shkrim, njoftimin për intervistën me gojë dhe vendimin për përzgjedhjen e kandidatit fitues do të publikohen në ueb- faqen e Komunës së Malishevës dhe tabelën e shpalljeve.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

**Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **20.01.2020 deri më datën:03.02.2020.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.



Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës



DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM

Adresa : Malishevë

Rr. "Skënderbeu", p.n

Email: [dkaemalisheva@gmail.com](mailto:dkaemalisheva@gmail.com)

Tel: 029-269-003

Nr. 11/ 39

Data: 20.01.2020

### Njoftim për anulim të konkursit

Anulohet konkursi i shpallur në gazetën "Epoka e Re" e datës 15 janar 2020 sepse gabimisht kemi dërguar konkurset e shpallura më herët. Dhe të vlefshëm mbetën konkurset e shpallura në ueb faqet e komunës konkursi me nr: 11/2971 datë: 17.12.2019, konkursi nr: 11/2931 datë: 09.12.2019 dhe konkursi me nr: 11/2941 datë: 11.12.2019

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LËKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

### FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës:  Furnizim  Shërbime  Punë

Nr. i Prokurimit 01-20

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: [info@omk-rks.org](mailto:info@omk-rks.org), me titullin:****Dosja për: Kontratë për furnizim me material shpenzues për zyret e OMK-së**

Në pajtim me Nenin 8, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

 Afati për parashkrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €). Afati për parashkrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

#### Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **27.01.2020 ora 14:00.**Afati i fundit për aplikim në Tender është: **29.01.2020 ora 12:00.**Hapja e ofertave bëhet me datën: **29.01.2019 ora 14:00.**

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Remzi (Naser) Kadriu, shpall të pavlefshme diplomën e SHMT. "Anton Çetta" Skenderaj.

► Petrit Derguti, shpall të pavlefshme diplomën e SHMT. (drejtimi tek. i makin) "Anton Çetta" Skenderaj.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistranja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.

Tel. 044-413-197.

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 ☎ +386 49 848 553

PRISHTINË



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

[www.facebook.com/giejpuneshpeite](http://www.facebook.com/giejpuneshpeite)



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

